



Hulumtim me **Portalet Online**  
**të Punësimit** dhe të  
**Diplomuarit e Shkollave**  
**Profesionale** në Kosovë

Përgatitur nga:



Autore: Nora Jusufi

Përgatitur për:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

**EYE** Enhancing Youth  
Employment

*Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit të saj Rritja e Punësimit për të Rinjtë (EYE), i implementuar nga Helvetas dhe MDA. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e IDRA Research and Consulting në Kosovë dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC-së.*

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....  | 8  |
| HYRJE .....   | 13 |
| REZULTATET E ANKETËS ME PORTALET E PUNËS .....  | 22 |
| 1. PROFILI I KOMPANISË DHE QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE .....                              | 22 |
| 2. NDIHMA DHE SUKSESI I PORTALEVE TË PUNËS NË NDËRMJETËSIM .....                        | 23 |
| REZULTATET E ANKETËS ME TË DIPLOMUARIT E ARSIMIT PROFESIONAL .....                      | 30 |
| 1. PROFILI I TË ANKETUARVE .....  | 33 |
| 2. LLOJI I TRAJNIMIT DHE KËNAQSHMËRIA ME TRAJNIMIN .....                                | 31 |
| 3. PUNËSIMI AKTUAL DHE MUNDËSITË E PUNËSIMIT .....                                      | 36 |
| 4. EFIKASITETI I TRAJNIMEVE DHE NDIKIMI TEK TË DIPLOMUARIT .....                        | 51 |
| PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....  | 57 |
| PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....  | 58 |
| Aneks I: Lista e shkollave të kontaktuara për anketimin e të diplomuarve të AP-së ..... | 59 |
| Aneks II: Të diplomuarit e arsimit profesional (AP) sipas Komunës .....                 | 60 |

## Lista e Figurave

|   |    |
|---|----|
| Figura 1 Gjinia e të anketuarve të portaleve të punës .....   | 22 |
| Figura 2 Rajoni i portaleve të punës .....  | 22 |
| Figura 3 Vitet e funksionimit të portaleve të punës .....   | 22 |
| Figura 4 Statusi ligjor i portaleve të punës .....  | 22 |
| Figura 5 Ndryshimet e të ardhurave në krahasim me vitin 2019 .....  | 23 |
| Figura 6 Ndryshimet e shpenzimeve në krahasim me vitin 2019 .....   | 23 |
| Figura 7 Mbyllja financiare e vitit të fundit (2020) të portaleve të punës .....  | 23 |
| Figura 8 Modeli i të ardhurave nga punëdhënësit *përgjigje e shumëfishtë .....  | 24 |
| Figura 9 Modeli i të ardhurave nga punëkërkuessit * përgjigje e shumëfishtë .....   | 24 |
| Figura 10 Shërbimet e ofruara përmes portalit të punës .....  | 24 |
| Figura 11 Grup moshë që përdor portalet e punës më së shumti për të kërkuar punë .....  | 24 |
| Figura 12 Tri komunat kryesore në të cilat punëkërkuessit fokusojnë aktivitetin e tyre në kërkimin e punës *lejohe tre përgjigje .....              | 25 |
| Figura 13 Të diplomuarit AP sipas gjinisë .....   | 30 |
| Figura 14 Të diplomuarit AP sipas moshës .....  | 30 |
| Figura 15 Të diplomuarit AP sipas etnisë .....  | 30 |
| Figura 16 Të diplomuarit e AP sipas vendbanimit .....   | 30 |
| Figura 17 Të diplomuarit e AP sipas rajonit .....   | 30 |
| Figura 18 Të diplomuarit AP sipas të ardhurave mujore familjare .....   | 31 |
| Figura 19 Viti i diplomimit .....   | 31 |
| Figura 20 Ritmi i trajnimit .....   | 31 |
| Figura 21 Dobia e njohurive të fituara gjatë shkollës .....   | 32 |
| Figura 22 Dobia e aftësive të fituara gjatë shkollës .....  | 32 |
| Figura 23 Arsyet prapa konsiderimit të njohurive si shumë të dobishme/të dobishme .....   | 33 |
| Figura 24 Arsyet prapa konsiderimit të shkathtësive si shumë të dobishme/të dobishme .....  | 34 |
| Figura 25 Përfitimet profesionale nga programi i ndjekur .....  | 35 |
| Figura 26 Përfitimet financiare nga programi i ndjekur .....  | 36 |
| Figura 27 Statusi i punësimit i të diplomuarve të AP .....  | 36 |
| Figura 28 Statusi i punësimit i të diplomuarve të AP sipas rajonit .....  | 37 |
| Figura 29 Kanalet e informimit për punën aktuale, *vetëm një përgjigje .....  | 38 |
| Figura 30 Koha që u desh për të gjetur një punë që nga diplomimi, * vetëm të diplomuarit e AP -së të punësuar .....                                 | 38 |
| Figura 31 Koha që u desh për të gjetur një punë që nga diplomimi, * vetëm të diplomuarit e AP -së të punësuar sipas vitit të diplomimit .....       | 39 |
| Figura 32 Koha që u desh për të gjetur një punë që nga diplomimi, * vetëm të diplomuarit e AP -së të punësuar sipas profilit të trajnimit .....     | 40 |
| Figura 33 Sektori i punësimit i të diplomuarve të AP-së .....   | 41 |
| Figura 34 Lidhja e punës/praktikës me aftësitë e fituara gjatë shkollimit profesional .....   | 41 |
| Figura 35 Planet për kërkimin e një pune *të diplomuarit e AP të papunë, studentë ose praktikantë .....   | 42 |
| Figura 36 Kërkimi i punës që nga fundi i shkollës së mesme, *vetëm të diplomuarit e AP-së të papunë .....   | 42 |
| Figura 37 Arsyet për mos kërkimin e një pune, *vetëm ata që nuk kanë kërkuar punë që nga mbarimi i shkollës së mesme .....                          | 43 |
| Figura 38 Numri mesatar i vendeve të punës në të cilat kanë aplikuar, *vetëm ata që kanë aplikuar për punë që nga mbarimi i shkollës së mesme ..... | 43 |

|   |    |
|---|----|
| Figura 39 Kanalet e informimit për vendet e punës në të cilat kanë aplikuar që nga diplomimi, *deri në tri zgjedhje.....              | 44 |
| Figura 40 Regjistrimi i të diplomuarve të AP -së në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës..                                  | 44 |
| Figura 41 Këshilla për mundësitë e punësimit nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës .....                                   | 45 |
| Figura 42 Njoftimet për konkurse të punës nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës .....                                     | 45 |
| Figura 43 Aplikimet për punë të të gjithë të diplomuarve të AP -së në 6 muajt e fundit.....   | 46 |
| Figura 44 Aplikimet për punë të të gjithë të diplomuarve të AP -së në 12 muajt e fundit.....  | 46 |
| Figura 45 Mënyra e aplikimit e të gjithë të diplomuarve të AP -së.....  | 46 |
| Figura 46 Pajtimi me deklaratën "Unë do të gjej një punë në 12 muajt e ardhshëm" .....  | 47 |
| Figura 47 Pajtimi me deklaratën "Unë do të gjej një punë në 24 muajt e ardhshëm" .....  | 47 |
| Figura 48 Pajtimi me deklaratën “Falë shkollës në të cilën kam diplomuar; më pret një e ardhme profesionale shumë e suksesshme” ..... | 48 |
| Figura 49 Pajtimi me deklaratën “Falë shkollës në të cilën kam diplomuar; më pret një e ardhme shumë e suksesshme financiare” .....   | 48 |
| Figura 50 Pajtimi me deklaratën “Në të ardhmen, dua të ushtroj aktivitetin tim profesional në Kosovë” .....                           | 49 |
| Figura 51 Pajtimi me deklaratën “Në të ardhmen, dua të ushtroj aktivitetin tim profesional jashtë Kosovës” .....                      | 49 |
| Figura 52 Sa e vështirë mendoni se është të gjejsh një punë në Kosovë? .....  | 50 |
| Figura 53 Sa e vështirë mendoni se është të gjejsh një punë në Kosovë në profesionin tënd? .....                                      | 50 |
| Figura 54 Efikasiteti i mësimave teorike në shkollë .....   | 51 |
| Figura 55 Ndikimi i njohurive të fituara nga mësimet teorike në jetën profesionale të të diplomuarve të AP -së.....                   | 51 |
| Figura 56 Vënia në përdorim e njohurive të fituara përmes orëve teorike.....  | 52 |
| Figura 57 Efektiviteti i mësimave praktike në shkollë.....  | 52 |
| Figura 58 Ndikimi i njohurive të fituara nga mësimet praktike në jetën profesionale të të diplomuarve të AP -së.....                  | 53 |
| Figura 59 Vënia në përdorim e njohurive të fituara përmes orëve praktike .....  | 53 |
| Figura 60 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen e aplikimit për punë .....   | 54 |
| Figura 61 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen e letrës së motivimit .....  | 54 |
| Figura 62 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen e një CV .....   | 54 |
| Figura 63 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen për intervistat e punës .....  | 54 |
| Figura 64 Kurse/Trajnime e mbajtura nga qendrat e karrierës në shkollë që ishin më të dobishme për të gjetur një punë.....            | 55 |
| Figura 65 Ndikimi i njohurive të fituara nga qendrat e karrierës në shkollë në jetën profesionale të të diplomuarve të AP-së .....    | 55 |

## Lista e Tabelave

|   |    |
|---|----|
| Tabela 1 Shkalla e papunësisë në Kosovë sipas grupmoshave 2020 .....                        | 15 |
| Tabela 2 Statistikat e portaleve të punës për anëtarët dhe njoftimet për punë .....         | 26 |
| Tabela 3 Statistikat e portaleve të punës për kompanitë e reja dhe vizitat në uebfaqe ..... | 27 |
| Tabela 4 Informata mbi shërbimet e portaleve të punës përmes uebfaqeve.....                 | 29 |
| Tabela 5 Arsyet prapa konsiderimit të njohurive si shumë të padobishme/të padobishme .....  | 34 |
| Tabela 6 Arsyet prapa konsiderimit të shkathtësive si shumë të dobishme/të dobishme .....   | 34 |
| Tabela 7 Sugjerime për të përmirësuar cilësinë e mësimave.....                              | 35 |

## Lista e Akronimeve

ARBK - Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

ARPK - Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

EYE - Rritja e Punësimit të Rinjve

MDA - Management Development Associates

SDC - Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

AP - Arsimi Profesional



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti Rritja e Punësimit për të Rinjtë (EYE) ka angazhuar IDRA Research and Consulting në Kosovë për të krijuar studimet bazë për një ndër treguesit kryesorë të Rezultatit 2 të projektit EYE. Rezultati dhe treguesit përkatës të saj janë si më poshtë:

**Rezultati 2** *"Të rejtat dhe të rinjtë bëjnë zgjedhje të informuara të karrierës dhe kanë më shumë mundësi punësimi përmes një sistemi të përmirësuar të informacionit të tregut të punës"* duke treguar ndryshimin në kohë që i duhet një të riu/reje për të gjetur punë përmes ndërmjetësimit të tregut të punës dhe sa përqind e njerëzve kanë gjetur një punë në 24 muajt e fundit përmes qendrave të karrierës dhe portaleve të punës.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të nxjerrë në pah gjetjet nga ky studim për treguesit e Rezultatit 2 të projektit EYE përmes 2 anketave të cilat masin rezultatet e punës së EYE në lehtësimin e punësimit të grave dhe burrave të rinj në Kosovë.

Studimet bazë për këta tregues përshijnë dy anketa:

- Anketë me portalet e punës në Kosovë si ndërmjetësuese të tregut të punës për Rezultatit 2, N=10 me rezultate indikative.
- Anketë me të diplomuarit e Arsimit Profesional (AP)/Shkollave të mesme profesionale për Rezultatit 2, N=500 me rezultate statistike të rëndësishme me një marzhë gabimi prej 4% dhe një interval besueshmërie 95%.

Seksioni i mëposhtëm thekson gjetjet kryesore që rezultojnë nga dy anketat që i përgjigjen Rezultatit 2 dhe treguesve të tyre përkatës.

### GJETJET KRYESORE:

**Rezultati 2** *"Të rejtat dhe të rinjtë bëjnë zgjedhje të informuara të karrierës dhe kanë më shumë mundësi punësimi përmes një sistemi të përmirësuar të informacionit të tregut të punës"*

#### **Portalet e punës**

##### **Profili i kompanisë dhe qëndrueshmëria financiare**

- Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e katër portaleve të punës mbetën afërsisht në të njëjtin nivel, dhe për dy prej tyre u ulën, tre portale pune nuk e dhanë këtë informatë, dhe një i anketuar nuk e kishte këtë informatë.
- Ndërsa, në krahasim me të njëjtën periudhë, ndryshimet e shpenzimeve nga 2019 mbetën përafërsisht në të njëjtin nivel për gjashtë portale pune, tre refuzuan të japin këtë informatë, dhe një i anketuar përsëri nuk e kishte këtë informatë.
- Të gjitha portalet e punës të anketuara (10) gjenerojnë të ardhura nga vendosja e pagesave për njoftimet e konkurseve të punës, shtatë prej portaleve vendosin pagesa për postime edhe në mediat e tyre sociale, katër prej tyre gjenerojnë të ardhura përmes reklamave në uebfaqe, katër prej tyre vendosin pagesa për profile të theksuara të kompanisë në portale, dhe dy prej tyre secila gjithashtu vendosin pagesa për qasje në CV-të e punëkërkuarëve, email-a të targetuara kundrejt kandidatëve, postime të kryqëzuara dhe pako, dhe vetëm një portal gjithashtu gjeneron të ardhura me reklama të vendosura në buletine informative.

- Vetëm katër portale vendosin pagesa për anëtarësimin e punëkërkuësve dhe një prej tyre po ashtu vendos pagesa për raporte informative (informata përmes librave elektronikë rreth kërkimit të punës, intervistave, rezymeve, anketave mbi nivelin e pagave, etj.).

### ***Ndërmjetësimi i tregut të punës***

- Tetë portale të punës ofrojnë njoftime për vende të lira pune nga punëdhënësit, gjashtë prej tyre ofrojnë shërbime rekrutimi, tre prej tyre ofrojnë publikim të postimeve të individëve që kërkojnë punë, dy prej tyre ofrojnë shërbime të aplikimit për punë dhe vetëm një prej tyre ofron hapësirë për të ngarkuar CV në portal, përgatitjes së CV-së në portal, dërgon njoftime të përgjithshme pune ose njoftime pune të përshtatura për anëtarët, dhe ofron trajnime falas për punëkërkuësit në proceset e aplikimit për punë.
- Lidhur me përdorimin e mediave sociale përveç faqes zyrtare të portalit, shumica e kompanive deklaruan se Facebooku çon në vizitat më të larta në uebfaqe. Të rriturit e rinj duket se janë grupi i cili më së shumti përdor portale pune për të kërkuar një punë, përkatësisht 25-34 vjeç.
- Tre vendndodhjet kryesore në të cilat punëkërkuësit përqendrojnë aktivitetin e tyre në kërkimin e punës janë Prishtina, Ferizaji dhe Prizreni, ndërsa një nga secila prej portaleve përmendi edhe Gjilanin, Pejën, Lipjanin dhe Podujevën.
- Asnjë nga portalet nuk bën sondazhe me anëtarët që kërkojnë punë për të parë nëse ata kanë gjetur punë përmes portalit të tyre dhe as nuk bëjnë sondazhe me punëdhënësit për të parë nëse kanë punësuar dikë nga platforma e tyre.
- Asnjë nga portalet e punës private nuk bashkëpunon me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës që të ndërmjetësojë komunikimin në mes punëkërkuësve dhe punëmarrësve.
- Ka numra të ndryshëm të kompanive dhe/ose institucioneve të tjera që përdorin këto portale pune. Tre portale pune kanë 20-30 kompani/institucione që përdorin portalin për të shpallur vendet e lira të punës. Tre portale pune deklarohen se kanë 150, 200 dhe 'qindra' kompani/institucione që përdorin portalin për të shpallur vendet e lira të punës. Një portal pune deklaroi se kishte mbi 1,200 kompani/institucione që përdorin portalin për të shpallur vendet e lira. Dy përfaqësues të dy portaleve të punës deklaruan se nuk kishin numra të saktë për numrin e kompanive/institucioneve që përdorin portalin e tyre, dhe njëri refuzoi të zbulonte atë shifër.
- Sa i përket numrit të individëve të regjistruar ose punëkërkuësve në platformë, diferenca është e madhe - për shembull, njëri prej tyre deklaroi 25, një tjetër më shumë se 1,600, një tjetër 10,000, dhe një më shumë se 60,000 anëtarë të regjistruar.
- Sa i përket numrit të punëve të postuara në ditë në portal numrat dallojnë nga tre në 30. Ndërsa, numri i njoftimeve për punë në muaj ndryshon nga 30-1,000 dhe ato në vit ndryshojnë nga 3,500 në 12,000.

### ***Të diplomuarit e shkollave të mesme të arsimit profesional (AP)***

#### ***Kënaqshmëria, dobia dhe efektiviteti i trajnimit***

- Më shumë se gjysma e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional (57%) e konsideruan ritmin e programit në të cilin kishin qenë të regjistruar si as të shpejtë, as të ngadalshëm dhe rreth 42% e konsideruan atë si shumë të shpejtë. Për më tepër, të dhënat treguan se studentët e diplomuar në institucionet e arsimit profesional që kanë bashkëpunuar me EYE e konsideruan

programin shumë të shpejtë (44%) kundrejt atyre që janë diplomuar në institucionet e arsimit profesional që nuk kanë punuar me EYE (39% respektivisht).

- Lidhur me dobinë e njohurive dhe aftësive të fituara gjatë programit të cilin ata ndoqën, rreth 80% dhe 77% e të diplomuarve të arsimit profesional i konsideruan ato si shumë të dobishme/të dobishme, respektivisht. Nxënësit që kanë qenë pjesë e shkollave që kanë bashkëpunuar me projektin EYE e konsideruan programin e shkollës si shumë të dobishëm/të dobishëm (82%), dhe 72% e atyre që ishin pjesë e shkollave që nuk kanë bashkëpunuar me EYE e konsideruan programin të dobishëm.
- Programet u konsideruan të dobishme kryesisht për shkak të gjërave të mësuara që u perceptuan si të përshtatshme për kërkesat e tregut të punës (32%), për shkak se kishin mësues të mirë dhe profesionistë (21%) si dhe literaturë moderne (21%).
- Më shumë të diplomuar nga shkollat partnere të EYE se sa ata nga shkollat jo partnere të EYE vlerësuan programin shkollor si të dobishëm për shkak të gjetjes së një pune në sajë të programit në të cilën ishin të regjistruar (16% dhe 9% respektivisht).
- Shumë pak të diplomuar (19 prej tyre) besuan se njohuritë dhe aftësitë e fituara ishin shumë të padobishme ose të padobishme kryesisht për shkak të pamundësisë për të gjetur një punë me diplomën e marrë (12 dhe 11 të anketuar respektivisht).
- Ata që i konsideruan njohuritë dhe aftësitë e padobishme, sugjeruan që për të përmirësuar cilësinë e arsimit në shkollat e tyre, shkolla duhet të sigurojë më shumë praktika dhe orë praktike në kompani të ndryshme, të përdorë tekste shkollore moderne, të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të përmirësojë kushtet e kabineteve.
- Tre të anketuar deklaruan se problemet nuk qëndrojnë tek cilësia e mësimdhënies, por në 'profilin' që ata zgjedhën me të cilin nuk mund të gjejnë punë në tregun e punës të Kosovës pa marrë edhe një diplomë fakulteti.
- Rreth gjysma e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional besojnë se i pret një e ardhme e suksesshme profesionale dhe financiare falë programit në të cilin ata kanë diplomuar (54% dhe 50% respektivisht).
- Një pjesë e madhe e të diplomuarve të arsimit profesional i konsideruan mësimet teorike dhe praktike të mësuara gjatë shkollës së mesme profesionale si efektive<sup>1</sup> ose shumë efektive (76% dhe 79% respektivisht).

### ***Punësimi aktual dhe mundësitë e punësimit***

- Pothuajse gjysma e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional të viteve akademike 2018/2019 dhe 2019/2020 janë të punësuar. Konkretisht, 42.2% e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional janë të punësuar ose me kohë të plotë (37.2%), me kohë të pjesshme (1.2%), të vetëpunësuar (3%), apo përmes praktikave të paguara ose të papaguara (0.8%). Pothuajse një e treta e tyre kanë vazhduar studimet (31.2%) dhe 24.4% janë të papunë.
- Shumica e të diplomuarve të arsimit profesional që janë të punësuar gjetën punë brenda 24 muajve nga diplomimi. Në të vërtetë, shumica e tyre (90%) gjetën punë brenda 9 muajve nga diplomimi dhe vetëm 10% e tyre gjetën punë në 10-24 muaj. Të gjithë të diplomuarit e AP -së u pyetën më tej se sa kanë përfitur profesionalisht nga programi që kanë ndjekur, me ç'rast 40% e tyre kanë pohuar se kanë përfitur shumë, 42% kanë pohuar se kanë përfitur deri diku.

---

<sup>1</sup> Shënim në përkthimin e raportit në gjuhën shqipe: Shprehja e përdorur gjatë anketimit ishte 'efektive/frytdhënëse' në pyetjet drejtuar të anketuarve.

- Meqenëse vetëm të diplomuarit e vitit 2018/2019 kanë diplomuar 26 muaj para kohës së anketimit, mostra e këtyre të diplomuarve të punësuar u shqyrtua në detaje për sa i përket kohës që u është dashur të punësohen. Pothuajse të gjithë të diplomuarit e punësuar të vitit 2018/2019 gjetën punë brenda 24 muajve. Rreth 52% e të diplomuarve të vitit 2018/2019 gjetën punë brenda 0-3 muajve, 20% brenda 4-6 muajve, 8% brenda 7-9 muajve, 10% brenda 10-12 muajve, 3% brenda 16-18 muajve, 2% brenda 19-21 muajve, 3% brenda 22-24 muajve dhe 2% në më shumë se 24 muaj.
- Ndërsa, 55% e të diplomuarve të vitit 2019/2020 kanë gjetur punë brenda 0-3 muajve, 25% brenda 4-6 muajve, 9% brenda 7-9 muajve, dhe 11% brenda 10-12 muajve.
- Shumica e të diplomuarve të arsimit profesional të punësuar u informuan përmes familjes, miqve ose të njohurve për punët që ata aktualisht mbajnë (73%). Një deri në tetë përqind e të diplomuarve përmendin uebfaqet zyrtare të kompanive, Facebookun, qendrën e karrierës së shkollës së tyre; katër prej tyre Instagramin dhe fletushkat fizike të reklamave të vendeve të punës si kanal informacioni për punët e tyre aktuale. Asnjë prej tyre nuk përmendi portalet e punës.
- 97% e të diplomuarve të arsimit profesional janë të punësuar në sektorin privat dhe 3% në sektorin publik.
- Më pak se gjysma e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional (45%) të cilët janë të punësuar ose duke bërë praktikë pohuan se puna që ata mbajnë ndërlidhet me aftësitë e fituara gjatë shkollave të tyre të mesme profesionale, ndërsa 55% pohuan të kundërtën.
- Pothuajse gjysma e atyre që kanë aplikuar për punë që nga diplomimi i shkollës së mesme (49%) kanë aplikuar në 1-3 vende pune, ndërsa rreth 36% e tyre kanë aplikuar në 4-6 vende pune deri tani (deri në qershor 2021).
- Kishte 46 të diplomuar të arsimit profesional të cilët pohuan se nuk kanë aplikuar për punë fare. Arsyet prapa mos aplikimit dallonin mes të anketuarve. Ata pohuan se nuk kanë aplikuar për punë, sepse ata janë duke studiuar dhe nuk kanë kohë për të punuar (28%), nuk besojnë se do të gjejnë punë (8%), nuk duan të punojnë për paga të ulëta (8%), duhet të kujdesen për punët e shtëpisë dhe familjen (8%), ndërsa disa nuk duan të punojnë (5%) ose marrin të ardhura nga familja jashtë vendit (3%).
- Më shumë se gjysma (53%) e të diplomuarve të arsimit profesional u informuan përmes familjes, miqve ose të njohurve për punët në të cilat aplikuan, 12% u informuan përmes Facebookut, 9% nga njoftimet e faqeve zyrtare të kompanive, dhe 6% përmes portaleve të punës dhe Instagramit.
- Vetëm 6% e të diplomuarve të arsimit profesional ishin regjistruar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, ndërsa 3% e tyre nuk e dinin që ajo agjenci ekzistonte.
- Rreth 44% e të diplomuarve të arsimit profesional të papunë ishin mjaft të sigurt se do të gjenin punë brenda 12 muajve.
- Rreth 50% e të diplomuarve të arsimit profesional të papunë ishin të sigurt se do të gjenin punë brenda 24 muajve.



**HYRJE**

## HYRJE

Rritja e Punësimit për të Rinjtë (EYE) është projekt i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation Kosovo dhe Management Development Associates (MDA). Qëllimi i fazës përmbyllëse (faza III) të projektit EYE është rritja e punësimit të grave dhe burrave të rinj në Kosovë. Kjo tentohet të arrihet përmes qasjes së përmirësuar në trajnime dhe arsimim të mëtejshëm (arsim profesional jo-formal) dhe përmes qasjes së përmirësuar në shërbime të integritit dhe informimit të tregut të punës.

Prandaj, EYE ka angazhuar IDRA Research and Consulting në Kosovë për të krijuar studimet bazë për treguesit kryesorë të Rezultatit 2 të projektit EYE. Qëllimi sipas Rezultatit 2 është që gratë dhe burrat e rinj të bëjnë zgjedhje të mirinformuara për karrierën dhe të kenë më shumë mundësi punësimi përmes një sistemi më efikas të informacionit të tregut të punës.

IDRA Research and Consulting në Kosovë mbështeti EYE në hartimin e metodave dhe instrumenteve të hulumtimit, mbledhjen, analizimin dhe vizualizimin e të dhënave bazë dhe hartimin e një raporti përfundimtar me rezultatet.

Kështu, detyrat e IDRA ishin:

- ▶ Propozimi i metodave dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave dhe për treguesit e Rezultatit 2
- ▶ Përgatitja e instrumenteve të hulumtimit
- ▶ Mbledhja e informatave kontaktuesve nga partnerët e EYE-it në mënyrë që të kenë mundësi të mbledhin të dhëna nga anketat
- ▶ Mbledhja e të dhënave nga anketat si burime parësore dhe përdorimi i informatave të tjera publike si burime dytësore
- ▶ Hartimi i një raport përfundimtar me gjetjet nga anketat e studimeve bazë

Pjesa e mëposhtme e raportit përfshin një përmbledhje të projektit EYE, metodologjinë e hulumtimit të këtij studimi, rezultatet e anketave me portalet e punës dhe me të diplomuarit e arsimit profesional ndjekur nga përfundimet dhe rekomandimet.



# PËRMBLEDHJE E EYE

## PËRMBLEDHJE E EYE

**Treguesit e fundit kryesorë të punësimit tregojnë një gjendje shqetësuese për situatën e punësimit në Kosovë.** Bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e punësimit në vitin 2020 është 28.4%. Shkalla më e lartë e punësimit është për burrat 42.8%, ndërsa punësimi për gratë është 14.1%. Për më tepër, papunësia është më e larta tek gratë me 32.3%, krahasuar me 23.5% për burrat. Shkalla më e theksuar e papunësisë është në grupmoshën 15-24 vjeç me 49.1%. Sektorët kryesorë ekonomikë me punësim vazhdojnë të jenë: tregtia me 17.0%; prodhimi me 11.8%; ndërtimi me 11.1%; dhe arsimit me 10.1%. Gratë janë të punësuar kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 52.7% të tyre, ndërsa burrat janë të punësuar kryesisht në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe prodhimit me 44.1% të tyre. Në sektorin formal, rreth 42.3% e punonjësve kanë kontrata të përhershme, ndërsa 57.7% kanë kontrata të përkohshme.

**Pandemia ka pasur ndikim madh në trendet makroekonomike në Kosovë.** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) publikoi raportin e tretë vjetor të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Sektoriale 2018-2022 (SS) - një plan strategjie i cili synon të krijojë një mjedis ku të gjithë qytetarët do të kenë mundësi të barabarta në punësim si dhe mbrojtje dhe përfshirje sociale të garantuar për ta bërë një jetë shoqërore dhe ekonomike dinjitoze. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se kufizimi i lëvizjes së qytetarëve dhe mbyllja e bizneseve rezultoi në një ngadalësim të ekonomisë, duke shkaktuar probleme në tregun e punës i cili është karakterizuar nga një shkallë e lartë e papunësisë. Këto deklarata u bënë duke iu referuar shkallës së papunësisë dhe numrit të rritur të punëkërkuësve në APRK.<sup>2</sup>

**Shkalla e papunësisë është shumë e lartë në mesin e të rinjve** (sipas AFP Q4 2020, 49.9% e të rinjve janë të papunë), përfshirë nivelin e lartë të individëve të rinj të moshës 15-24 vjeç, të cilët nuk ishin të përfshirë në punësim, arsimim ose trajnim (i njohur si "NEET"), gjatë së njëjtës periudhë (31.5%). Gjithashtu, papunësia afatgjate mbetet e lartë, me 74.2% të të papunëve të regjistruar që janë të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj). Sipas bazës së të dhënave të ASK-së, shkalla e papunësisë për 15-24-vjeçarët është 49.1%, për 25-34-vjeçarët është 31.4%, për 35-44-vjeçarët është 20.1%, për 45-54-vjeçarët është 17.2% dhe për 15-64-vjeçarët është 25.9%.<sup>3</sup>

Tabela 1 Shkalla e papunësisë në Kosovë sipas grupmoshave 2020

| Grupmosha | Shkalla e papunësisë (%) |       |
|-----------|--------------------------|-------|
|           | 2020                     |       |
|           | Total                    |       |
| 15-24     |                          | 49.1% |
| 25-34     |                          | 31.4% |
| 35-44     |                          | 20.1% |
| 45-54     |                          | 17.2% |
| 55-64     |                          | 9.8%  |
| 15-64     |                          | 25.9% |

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

<sup>2</sup> MPMS. "Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022" <<https://mpms.rks-gov.net/en/wpdm-package/strategjia-sektoriale-e-ministrise-se-punes-dhe-mireqenies-sociale-2018-2022/>>

<sup>3</sup> Databaza e ASK-së <[askdata.rks-gov.net](http://askdata.rks-gov.net)>

Ndërsa raporti MPMS-së thekson se Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) arriti të mbështesë 5,632 punëkërkuar përmes masave aktive të tregut pavarësisht nga boshllëqet në kapacitetet institucionale dhe situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, të dhënat e APRK-së tregojnë një rritje të shpejtë të numrit të të papunëve. Duke marrë parasysh që pandemia ka shkaktuar një rënie të punëtorëve në industri të ndryshme, Pakoja Fiskale Emergjente ishte një hap i duhur për të zvogëluar efektet e pandemisë në ekonominë e Kosovës. MPMS-ja më tutje thekson se norma e lartë e papunësisë mund të ketë çuar në një rritje të konsiderueshme të punëkërkuarve të regjistruar gjatë vitit 2020. Numri i punëkërkuarve në APRK ishte 201,935 gjatë vitit 2020, një rritje e madhe në krahasim me të dhënat e tremujorit të fundit të vitit 2019, kur numri i punëkërkuarve të regjistruar në APRK ishte vetëm 6,882.<sup>4</sup>

Shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë është pasojë e mospërputhjes strukturore me sistemit arsimor dhe tregut të punës. Kosova gjithashtu përballet me një nga kalimet më të ngadalta nga shkolla-në-punë në rajon dhe më gjerë.

EYE është një projekt katërvjeçar që implementohet nga konsorciumi i HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) dhe Management and Development Associates (MDA) i cili mbështet aktorët që kontribuojnë në: (1) përmirësimin e cilësisë së trajnimit/ofertave, zgjerimin e shtrirjes së ofruesve të trajnimit, pozicionimin më të mirë në treg dhe trajtimin e nevojave specifike të industrisë.

Gjatë periudhës katërvjeçare, EYE ka bashkëpunuar me Agjencinë e Punësimit, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, shoqatat e ndryshme të biznesit, kompanitë private, OJQ-të lokale, shkollat e arsimit profesional dhe ofruesit e trajnimeve private dhe gjithashtu ofruesit e ndërmjetësimit të punësimit.

Projekti EYE është përqëndruar në katër aspekte kryesore:

### **1. Mbështetja për Zhvillimin e Shërbimeve të Karrierës për Shkollat e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë.**

Krijimi i një shërbimi të përmirësuar dhe gjithëpërfshirës të orientimit të karrierës që siguron informacion të hershëm për studentët e Shkollave të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AFP) dhe lehtëson kalimin e tyre nga shkolla në punë ka qenë një nga aspektet kryesore në të cilat EYE ka punuar.

### **2. Mbështetja e ofruesve të trajnimeve jo-formale për të ofruar programe trajnimi të orientuara drejt kërkesës dhe gjithëpërfshirëse për të rinjtë.**

EYE ka mbështetur partnerë të shumtë me krijimin e qendrave të trajnimit, qoftë brenda ose si njësi të veçanta që i shërbejnë industrisë më të gjerë. Sektorët kryesorë me të cilët EYE ka punuar ishin TIK, prodhimi, dizajni, përpunimi i drurit, përpunimi i metaleve, pjekje dhe pastičeri, BPO dhe shitjet. Për më tepër, nismat që synonin shpërndarjen e informacionit rreth trajnimeve jo-formale të disponueshme dhe aftësitë që janë shumë të kërkuara në tregun e punës u mbështetën dhe u shtynë përpara nga EYE.

---

<sup>4</sup> MLSW. "Raporti i Monitorimit i Strategjisë Sektoriale 2018-2022" <<https://mpms.rks-gov.net/en/wpdm-package/strategjia-sektoriale-e-ministrise-se-punes-dhe-mireqenies-sociale-2018-2022/>>

### **3. Mbështetja e ofruesve publik dhe privat të shërbimeve të rekrutimit dhe të përputhjes së punës për të ofruar shërbime më të mira, gjithëpërfshirëse për punëkërkuarit dhe punëdhënësit e rinj.**

Një qëllim tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm që EYE ka synuar të arrijë ishte zbutja e disa prej barrierave të cilat shkaktojnë mospërputhjen e ofertës dhe kërkesës së aftësive në tregun e punës duke punuar si me shërbimet publike të punësimit ashtu edhe me ofruesit e shërbimeve private të përputhjes së punës. Qëllimi i projektit u fokusua në përmirësimin e ofertës së aftësive për të përputhur kërkesën ekzistuese të tregut, përmirësimin e rrjedhës së informacionit të tregut dhe mundësimin e qasjes në tregun e punës për grupet e marginalizuara.

### **4. Promovimi i Përfshirjes Sociale dhe Mbështetja e Komuniteteve të Pafavorizuara**

Rritja e punësimit të të rinjve dhe kontributi në një treg dinamik dhe gjithëpërfshirës të punës që siguron punë më të denjë për të rinjtë në Kosovë ka qenë gjithashtu një nga aspektet kryesore në të cilat ky projekt ka vënë fokusin e tij. Dëshira për të qenë një projekt i ndërgjegjshëm për barazinë gjinore dhe për barazinë sociale bëri që EYE të krijojë Strategjinë e saj për Përfshirjen Gjinore dhe Sociale në mënyrë që të përcaktojë një udhërrëfyes se si të arrihen qëllimet e saj të përfshirjes sociale dhe të sigurohet qëndrueshmëria e aktiviteteve specifike në mënyrë që t'u shërbejë komunitetet e pafavorizuara përtej mbështetjes së EYE.

Duke synuar rritjen e përdorimit të platformave të punës dhe shërbimeve publike të punësimit nga punëdhënësit dhe punëkërkuarit EYE gjithashtu ka punuar me ofruesit privat të shërbimeve të përputhjes së punës si: portalet online, agjencitë e rekrutimit, rekrutues, organizatat që ofrojnë shërbime të targetuara për gratë dhe pakicat, dhe Shërbimet Publike të Punësimit (SHPP).

Për të zbutur rreziqet dhe për të vlerësuar nëse pritjet përmbushin punën e bërë, EYE ka të vendosur një sistem të Monitorimit dhe Matjes së Rezultateve (MRM). Sistemi MMR është përdorur në planifikimin, hartimin, menaxhimin, rishikimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve në përputhje me qasjen e Zhvillimit të Sistemeve të Tregut (MSD) dhe duke përdorur standardin e Komitetit të Donatorëve për Zhvillimin e Ndërmarrjeve (DCED) për matjen e rezultateve. Falë sistemit MRM stafi EYE ka qenë në gjendje të menaxhojë kapjen dhe raportimin e rezultateve me praktikën më të mira në matjen e rezultateve.



# METODOLOGJIA

## METODOLOGJIA

Bazuar në qëllimin e projektit, IDRA Research and Consulting në Kosovë përdori një kombinim të metodave sasiore të hulumtimit dhe metodave cilësore të hulumtimit në mënyrë që të mblidhte rezultatet përkatëse për të matur treguesit e Rezultatit 2 të EYE dhe me sigurimin e zgjedhjes të mirinformuar të karrierës dhe mundësve të punësimit për të rinjtë, respektivisht.

### Dizajni dhe madhësia e mostrës

Për shkak të situatës me pandeminë COVID-19 dhe popullsisë specifike të targetuar, të dhënat u mblodhën përmes anketimit telefonik (CATI) me të diplomuarit e arsimit profesional dhe përmes anketimit online (CAWI) me portalet e punës.

Për qëllimin e këtij studimi, popullsia e targetuar janë portalet e punës dhe të diplomuarit e 15 shkollave të mesme profesionale publike në Kosovë. Më poshtë janë përshkruar aktivitetet e implementuara për secilën popullsi të targetuar.

**Portalet e punës:** Mostra për këtë përbëhej nga 10 portale të punës. Anketa përfshinte kryesisht pyetje të hapura dhe plotësohet nga informatat e plasuara online nga secili portal dhe meqenëse madhësia e mostrës është e vogël, rezultatet do të konsiderohen si cilësore dhe kështu interpretohen si vetëm si indikative.

**Të diplomuarit e arsimit profesional:** Mostra e kësaj ankete përbëhej nga 500 të diplomuar të shkollave të mesme profesionale dhe përfaqësonte 15 shkolla të përfshira në këtë studim, të cilat u ndanë në dy grupe: a) Shkollat e arsimit profesional që mbështeten nga EYE dhe b) shkolla të tjera të ngjashme të vendosura në të njëjtat komuna apo në afërsi, por që nuk janë mbështetur nga projekti EYE.

Në rastin e grupit të parë, EYE ka siguruar listën e kontakteve të shkollave të mesme të arsimit profesional që janë partnere të projektit, ndërsa IDRA ka identifikuar shkolla të tjera që ndodheshin në të njëjtat komuna apo në afërsi. Ne kemi përfshirë të diplomuar nga 9 shkolla partnere të EYE dhe 7 shkolla që nuk janë partnere të EYE të cilët kanë diplomuar në vitin 2018-2019 dhe 2019-2020 (Aneksi I ofron listën e kontakteve të shkollave për anketën me të diplomuarit e tyre). Ekipi i IDRA-s ka kontaktuar të gjitha shkollat për të marrë një listë të plotë të të diplomuarve të vitit 2018-2019 dhe 2019-2020 për të siguruar përfaqësim adekuat të të diplomuarve. Megjithatë për shkak të një popullsie shumë specifike të targetuar, mos përgjigjes së disa shkollave dhe mos përgjigjes së disa të diplomuarve, mostrat përfundimtare për të diplomuarit e arsimit profesional dallojnë. Të dhënat administrative nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se gjatë viteve akademike 2019/2020 ishin 37,878 nxënës të regjistruar në shkollat profesionale.<sup>5</sup> Duke konsideruar këtë numër si popullsia për studimin me të diplomuarit e shkollave profesionale, një mostër prej 500 nxënësve që kanë ndjekur këtë lloj edukimi jep një marzhë gabimi prej 4% me një interval besueshmërie prej 95%. Mostra e të diplomuarve të shkollave partnere të EYE është N=236 dhe mostra për shkollat jo partnere të EYE është N=162, duke siguruar rëndësi statistikore kur interpretohen rezultatet e përgjithshme dhe në bazë të partneritetit apo jo-partneritetit me EYE.

---

<sup>5</sup>Burimi: Së fundmi qasur në Gusht 2021: <https://ask.rks-gov.net/media/6073/education-statistics-20202021.pdf>

## Përgatitja e pyetësorit

Kurdo që IDRA Research and Consulting në Kosovë harton një studim bazë, ne sigurohemi që pyetësori të jetë hartuar sipas qëllimit dhe fokusit specifik të projektit. Pyetësorët janë përgatitur dhe testuar duke pasur temën kryesore në mendje, por edhe të mbledhur të dhëna demografike dhe/ose të dhëna profileve institucionale duke na lejuar të arrijmë në përfundime dhe të bëjmë krahasime në mes të komunave të ndryshme, rajone, etnive, grupmoshave, gjinive, dhe kategorive të tjera. Duhet të krijohet një lidhje kryesore midis qëllimeve të kërkimit dhe pyetjeve individuale përmes çështjeve të kërkimit. Kështu, ne gjithashtu u siguroam se pyetësorët përfshijnë pyetje që mund të përdoren për t'iu përgjigjur treguesve.

Anketa me **portalet e punës** synoi që më mirë të:

- ▶ kuptojë tregun e portaleve të punës
- ▶ kuptojë shërbimet e ofruara nga portalet e punës dhe modelet e të ardhurave të tyre
- ▶ kuptojë numrin e punëkërkuessve dhe punëdhënësve që përdorin portalet e tyre
- ▶ kuptojë shpeshësinë/frekuencën e njoftimeve për punë
- ▶ kuptojë nëse i përdorin mediat sociale përveç portalit online
- ▶ kuptojë nëse dhe si bashkëpunojnë me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK)
- ▶ kuptojë nëse dhe çfarë lloj mbështetje nga donatorët marrin

Anketa me **të diplomuarit** e shkollave profesionale publike të mesme (AP) në Kosovë synoi që mirë të:

- ▶ kuptojë nëse koha e kalimit nga shkolla në punë ndryshon mes burrave dhe grave
- ▶ kuptojë pjesën e të diplomuarve të arsimit profesional që kanë gjetur punë në 24 muajt e fundit përmes qendrave të karrierës dhe portaleve të punës
- ▶ kuptojë mundësitë e punësimit të të diplomuarve të arsimit profesional
- ▶ kuptojë informatat rreth karrierës së të diplomuarve të arsimit profesional



# REZULTATET E ANKETËS

## REZULTATET E ANKETËS ME PORTALET E PUNËS

Seksioni i mëposhtëm shpalos rezultatet e nxjerra nga anketa me portalet e punës. Duhet të theksohet se anketa u krye online dhe me vetëm dhjetë portale pune dhe synon të marrë një ide të përgjithshme të ngjashmërive dhe/ose dallimeve në shërbimet e ofruara nga kompanitë e anketuara. Gjithsej u kontaktuan 16 portale pune. Disa prej tyre nuk iu përgjigjën ftesës për pjesëmarrje në anketë dhe disa të tjerë nuk kishin informacion në lidhje me përdoruesit e tyre. Portalet e kontaktuara kishin një profil të përgjithshëm, kështu që ata shpallin kategori të ndryshme pune, pa u fokusuar në kategori të veçanta të punëve. Rezultatet e anketës duhet të interpretohen vetëm si indikative. Meqenëse madhësia e mostrës është e vogël, raporti do të interpretojë numra dhe jo përqindje. Anketa vlerësoi nëse portalet e punës kanë qëndrueshmëri financiare dhe të trajnimit, si dhe suksesin e tyre në ndërmjetësimin e tregut të punës.

### 1. PROFILI I KOMPANISË DHE QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE

Të anketuarit e anketës me portalet e punës ishin pronarë, menaxherë dhe asistentë. Kompanitë u përfaqësuan nga gjashtë gra dhe katër burra. Nëntë nga portalet e punës janë të vendosura në rajonin e Prishtinës dhe vetëm një prej tyre në rajonin e Ferizajt.

Figura 1 Gjinia e të anketuarve të portaleve të punës





Figura 2 Rajoni i portaleve të punës



Tri portale pune funksionojnë nga 0-2 vite, dhe tri prej tyre për 3-5 vite, ndërsa njëra funksionon qe më pak se një vit, 6-9 vite, ose 10-20 vite, ndërsa një nuk ka dhënë një përgjigje. Gjashtë nga portalet e punës janë kompani me përgjegjësi të kufizuar, tre prej tyre janë biznese individuale, dhe njëra prej tyre operon si person fizik.

Figura 3 Vitet e funksionimit të portaleve të punës





Figura 4 Statusi ligjor i portaleve të punës



Qëndrueshmëria financiare e portaleve të punës është gjithashtu jetike në suksesin e ndërmjetësimit në tregun e punës. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e katër portaleve të punës mbetën afërsisht në të njëjtin nivel, dhe për dy prej tyre u ulën, tre portale pune nuk e zbuluan këtë informacion dhe një i anketuar nuk e kishte këtë informacion. Ndërsa, në krahasim me të njëjtën periudhë, ndryshimet e shpenzimeve nga 2019 mbetën përafërsisht në të njëjtin nivel për gjashtë portale pune, tre refuzuan të zbulojnë informacionin, dhe një i anketuar përsëri nuk e kishte atë informacion. Ndërsa, katër portale ishin në rentabilitet edhe deri në fund të vitit 2020, dy e përfunduan vitin me humbje, tre refuzuan të zbulonin këtë informacion dhe një i anketuar nuk e dinte.

Figura 5 Ndryshimet e të ardhurave në krahasim me vitin 2019




Figura 6 Ndryshimet e shpenzimeve në krahasim me vitin 2019





Figura 7 Mbyllja financiare e vitit të fundit (2020) të portaleve të punës



## 2. NDIHMA DHE SUKSESI I PORTALEVE TË PUNËS NË NDËRMJETËSIM


Ky seksion i anketës eksplori modelet e të ardhurave të portaleve të punës nga punëdhënësit dhe punëkërkuarit, çfarë lloj shërbimesh ofrojnë, si ndërmjetësojnë në tregun e punës, nëse vlerësojnë punësimin ose suksesin e punësimin të anëtarëve, e kështu me radhë.

Të gjitha portalet e punës (10) gjenerojnë të ardhura nga vendosja e pagesave për punëdhënësit (kompani, organizata dhe institucione të tjera) për njoftimet e vendeve të lira të punës, shtatë prej portaleve gjithashtu vendosin pagesa për zgjerimet në media sociale (d.m.th. gjithashtu postojnë njoftimet për vendet e lira të punës përmes llogarive të portaleve në mediat sociale), katër prej tyre gjenerojnë të ardhura përmes reklamave në faqe, katër prej tyre vendosin pagesa për profilet e theksuara të kompanisë, dhe dy prej tyre secila gjithashtu vendosin pagesa për qasje në CV-të e punëkërkuarëve, emailat e targetuara kundrejt kandidatëve, postime e kryqëzuara dhe për pako shërbimesh (kombinimi i shërbimeve të ndryshme), dhe vetëm një portal gjithashtu gjeneron të ardhura përmes reklamave të vendosura në buletine informative. Vetëm katër portale vendosin pagesa të anëtarësimin për punëkërkuarit dhe një prej tyre gjithashtu vendos pagesa për raporte informative (p.sh. informata përmes librave elektronikë rreth kërkimit të punës, intervistave, rezymeve, anketave mbi nivelin e pagave, etj.).

Figura 8 Modeli i të ardhurave nga punëdhënësit  
\*përgjigje e shumëfishtë



Figura 9 Modeli i të ardhurave nga punëkërkesit  
\* përgjigje e shumëfishtë



Më tej, studimi eksplori llojet e shërbimeve të ofruara në këto portale pune. Tetë portale të punës ofrojnë njoftime për vende të lira pune nga punëdhënësit, gjashtë prej tyre ofrojnë shërbime rekrutimi, tre prej tyre ofrojnë publikim të postimeve që kërkojnë punë nga individë, dy prej tyre ofrojnë shërbime të aplikimit për punë dhe vetëm një prej tyre ofron hapësirë për të ngarkuar CV-të në portal, përgatitjes së CV-së në portal, dërgon njoftime të përgjithshme pune ose njoftime pune të përshtatura për anëtarët, dhe ofron trajnime falas për punëkërkesit në proceset e aplikimit për punë. Kur u pyetën nëse postojnë punë në mediat sociale përveç në faqen zyrtare të portalit, të gjitha kompanitë konfirmuan se e bëjnë këtë dhe nëntë prej tyre deklaruan se Facebooku çon në vizitat më të larta në faqe. Të rriturit e rinj duket se janë grupi i cili më së shumti përdor portale pune për të kërkuar një punë, përkatësisht 25-34 vjeçarët.

Figura 10 Shërbimet e ofruara përmes portalit të punës






Figura 11 Grup moshë që përdor portalet e punës më së shumti për të kërkuar punë



Portalet e punës kanë vizitorë të faqeve të cilët mund të përqendrojnë aktivitetin e tyre të kërkimit të punës në vende të ndryshme që mund të jetë tregues për interesin e tyre të veçantë që të punojnë në një vend të caktuar, besimin se kanë më shumë mundësi për të gjetur një punë, ose zgjedhin vendin ku jetojnë. Kur u pyetën në cilat tri komuna punëkërkesit e përqendrojnë më së shumti aktivitetin e tyre në kërkimin e punës, dhjetë portale përmendën Prishtinën, gjashtë përmendën Ferizajin, pesë përmendën Prizrenin dhe nga një prej tyre përmendën Gjilanin, Pejën, Lipjanin dhe Podujevën.

Sidoqoftë, asnjë nga portalet nuk bëjnë anketa me anëtarët që kërkojnë punë për të parë nëse ata kanë gjetur punë përmes portalit të tyre dhe as nuk bëjnë anketa me punëdhënësit për të parë nëse ata kanë punësuar dikë nga platforma e tyre e as nuk vlerësojnë këta numra në një mënyrë tjetër. Asnjë nga portalet private të punës nuk bashkëpunon me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës për të ndërmjetësuar komunikimin e punëkërkuësve dhe punëmarrësve.

Figura 12 Tri komunat kryesore në të cilat punëkërkuësit fokusojnë aktivitetin e tyre në kërkimin e punës \*lejohen tre përgjigje



Madhësia e shtrirjes që secili portal i punës ka në Kosovë duket të jetë e ndryshme. Nëpërmjet pyetjeve të hapura anketa kishte për qëllim të kuptonte disa nga statistikave të portaleve të punës për anëtarët e punëdhënësve dhe numrin e njoftimeve për punë. Ekzistojnë numra të ndryshëm të kompanive dhe/ose institucioneve të tjera që përdorin këto portale pune. Disa portale kanë vetëm 20-30 punëdhënës që përdorin portalin, disa mbi 150 deri në 200, dhe disa mbi 1,200. Sa i përket numrit të individëve të regjistruar ose punëkërkuësve në platformë, diferenca është e madhe - për shembull, njëri prej tyre deklaron 25, një tjetër më shumë se 1,600, një tjetër 10,000, dhe një më shumë se 60,000 anëtarë të regjistruar. Ndërsa, kur bëhet fjalë për numrin e punëve të postuara në ditë në portal numrat ndryshojnë nga tre në 30. Numri i njoftimeve për punë në muaj dallohet nga 30-1,000 dhe ato në vit dallojnë nga 3,500 në 12,000.

Tabela 2 Statistikat e portaleve të punës për anëtarët dhe njoftimet për punë

| Portalet          | # i kompanive që përdorin portalin | # i individëve të regjistruar që përdorin portalin | # i postimeve të punës në ditë | # i postimeve të punës në muaj | # i postimeve të punës në vit |
|-------------------|------------------------------------|--|--------------------------------|--------------------------------|-------------------------------|
| Portali i Punës A | Mbi 150                            | 10,000   | 25                             | 750                            | 9,000                         |
| Portali i Punës B | N/A                                | Nuk është e aplikueshme                            | 10                             | 250                            | 3,000                         |
| Portali i Punës C | 25                                 | 25   | 20                             | 600                            | 7,200                         |
| Portali i Punës D | Qindra                             | more than 60,000                                   | 30                             | 1,000                          | 12,000                        |
| Portali i Punës E | Mbi 1,200                          | Nuk është e aplikueshme                            | Mbi 12                         | Mbi 320                        | Mbi 3,600                     |
| Portali i Punës F | Refuzoj të përgjigjem              | Refuzoj të përgjigjem                              | Refuzoj të përgjigjem          | Refuzoj të përgjigjem          | Refuzoj të përgjigjem         |
| Portali i Punës G | Përafërsisht 200                   | Përafërsisht 1,600                                 | 18                             | 320                            | 3,500                         |
| Portali i Punës H | 30                                 | Nuk ka informata                                   | 20                             | 600                            | 7,200                         |
| Portali i Punës I | 20                                 | Nuk është e aplikueshme                            | 3                              | 30                             | Nuk ka të dhëna               |
| Portali i Punës J | Nuk ka informata                   | Nuk ka informata                                   | Nuk ka informata               | Nuk ka informata               | Nuk ka informata              |

Anketa tutje pyeti për statistikat e entiteteve të reja që përdorin shërbimet e tyre për herë të parë çdo muaj dhe çdo vit, si dhe numrin e vizitave në uebfaqe në ditë, muaj dhe vit. Në mënyrë të ngjashme, si me informatat mësipërm, disa portale të punës kanë vetëm dy entitete të reja që përdorin shërbimet e tyre në një muaj dhe disa deklarojnë 50 kompani të reja në muaj. Ndërsa, kompanitë e reja që përdorin shërbimet në portal në vit dallojnë nga 25 në 300. Sa i përket numrit të vizitave në uebfaqe në ditë, disa deklarojnë 1,000, disa 5,000, disa 7,000, disa 30,000, dhe disa mbi 35,000 vizita në ditë. Të dhënat për vizitat mujore në uebfaqe gjithashtu ndryshojnë midis dhjetëra dhe qindra mijëra deri në një milion. Ndërsa, të dhënat për vizitat vjetore në uebfaqe ndryshojnë nga 360,000 deri në 2,500,000 vizita.

Tabela 3 Statistikat e portaleve të punës për kompanitë e reja dhe vizitat në uebfaqe

| Portalet          | # i kompanive të reja që përdorin shërbimet e tyre për herë të parë në një muaj | # numri i kompanive të reja që përdorin shërbimet e tyre për herë të parë në një vit | # numri i vizitave në uebfaqe në ditë | # numri i vizitave në uebfaqe në muaj | # numri i vizitave në uebfaqe në vit |
|-------------------|---|--|---------------------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------|
| Portali i Punës A | 20  | 200  | 7,000                                 | 210,000                               | 2,500,000                            |
| Portali i Punës B | Nuk është e aplikueshme   | Nuk është e aplikueshme  | 1,000                                 | 30,000                                | 360,000                              |
| Portali i Punës C | 3   | 25   | 1,000                                 | 30,000                                | 360,000                              |
| Portali i Punës D | 20  | 250  | 30,000                                | 1,000,000                             | 1,200,000                            |
| Portali i Punës E | 10-50   | 100-300  | Mbi 35,000                            | Mbi 1 milion                          | Mbi 12 milion                        |
| Portali i Punës F | Refuzoj të përgjigjem   | Refuzoj të përgjigjem  | Refuzoj të përgjigjem                 | Refuzoj të përgjigjem                 | Refuzoj të përgjigjem                |
| Portali i Punës G | 3   | 40   | 5,000                                 | 130,000                               | 2 milion                             |
| Portali i Punës H | 2   | Nuk ka informata   | Nuk ka informata                      | Nuk ka informata                      | Nuk ka informata                     |
| Portali i Punës I | Nuk ka të dhëna   | Nuk ka të dhëna  | Nuk ka të dhëna                       | Nuk ka të dhëna                       | Nuk ka të dhëna                      |
| Portali i Punës J | Nuk ka informata  | Nuk ka informata   | Nuk ka informata                      | Nuk ka informata                      | Nuk ka informata                     |

Meqenëse informacioni i mësipërm ishte deklarativ dhe në kushte anonimiteti, raporti gjithashtu siguron disa informacione të mbledhura përmes burimeve dytësore, veçanërisht informacionit publik të dhënë në portalet e punës dhe llogaritë e tyre në mediat sociale për të plotësuar rezultatet e anketës.

Edhe pse aktiviteti kryesor i të gjitha portaleve të punës është të sigurojnë një hapësirë që lidh komunikimin midis punëdhënësve dhe punëkërkuësve, disa ofrojnë gjithashtu informacion mbi mundësitë e arsimimit të mëtejshëm. Për më tepër, disa portale fokusohen vetëm në tregun e punës të Kosovës; ndërsa të tjerat lidhin punësimin e qytetarëve kosovarë në vendet e tjera.

Shtirja e portaleve të punës në mediat sociale është e ndryshme dhe një nga arsyet mund të jetë për shkak të kohës për sa janë duke funksionuar. Disa kanë mijëra, ndërsa disa qindra mijëra ndjekës në Facebook, mes llogarive të tjera të mediave sociale.

Dhjetë portalet e punës ofrojnë shërbime të ndryshme të cilat gjithashtu u eksploruan përmes anketës së lartpërmendur. Nga informacionet e grumbulluara përmes uebfaqeve të tyre zyrtare, vetëm tre nga 10 portalet publikojnë vende të lira pune me anë të banerëve, premiumëve, dhe leaderboard and static, dhe katër nga 10 prej tyre ofrojnë publikimin e vendeve të lira të punës në mënyrë standarde. Një nga 10 portalet ofron mundësinë për të llogaritur pagën neto dhe bruto, pesë prej tyre ofrojnë mundësinë e krijimit të një CV-je në portal, katër prej tyre ofrojnë mundësinë ngarkimit të CV-së në portal dhe shkarkimit të CV-së nga portali, dhe pesë nga 10 portalet ofrojnë shembuj të CV-ve dhe udhëzime se si të përgatitet një CV, si dhe postojnë blogje dhe artikuj për edukim mbi karrierën.

Tabela 4 Informata mbi shërbimet e portaleve të punës përmes uebfaqeve

| Portal                                      | Publikimi i konkurseve për punë |         |                       |          | Shërbime të tjera            |                            |                                |                                 |   |  |  |
|---|---------------------------------|---------|-----------------------|----------|------------------------------|----------------------------|--------------------------------|---------------------------------|---|--|--|
|   | Banner                          | Premium | Lead erboard & Static | Standard | Llogaritja e pagës në portal | Krijimi i një CV në portal | Ngar kimi i CV - së në portali | Shkarkimi i CV - së nga portali | Shembull CV dhe udhëzime të shkruhet një CV | Edukimi në karrierë / Postimi i blogjeve dhe artikujve |  |
| Kastori                                     | ✓                               | ?       | ✓                     | ?        | ?                            | ?                          | ?                              | ?                               | ✓   | ✓  |  |
| Gjej Pune                                   | /                               | /       | /                     | /        | /                            | ✓                          | /                              | /                               |   | ✓  |  |
| Fillo Pune                                  | ✓                               | ✓       | ✓                     | ✓        | /                            | /                          | /                              | /                               | /   | /  |  |
| Portal Pune                                 | /                               | /       | /                     | /        | /                            | /                          | /                              | /                               | /   | ✓  |  |
| KosovaJob                                   | ✓                               | ✓       | ✓                     | ✓        | ✓                            | ✓                          | ✓                              | ✓                               | ✓   | ✓  |  |
| X Puna                                      | /                               | /       | /                     | ✓        | /                            | ✓                          | ✓                              | ✓                               | ✓   | ✓  |  |
| Prishtina Consulting Group/Burime Njerëzore | /                               | ✓       | /                     | ✓        | /                            | ✓                          | ✓                              | ✓                               | ✓   | /  |  |
| Students Network Employment                 | /                               | /       | /                     | /        | /                            | ✓                          | ✓                              | ✓                               | /   | /  |  |
| Puna Ime                                    | /                               | /       | /                     | /        | /                            | /                          | /                              | /                               | /   | /  |  |
| Bridgeway Agency                            | /                               | /       | /                     | /        | /                            | /                          | /                              | /                               | /   | /  |  |


## REZULTATET E ANKETËS ME TË DIPLOMUARIT E ARSIMIT PROFESIONAL

Seksioni i mëposhtëm analizon rezultatet e nxjerra nga anketa me të diplomuarit e shkollave të mesme profesionale, të njohura edhe si shkolla të Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AFP). Anketa vlerësoi nëse të diplomuarit e viteve shkollore 2018/2019 dhe 2019/2020 janë të kënaqur me arsimin që kanë marrë nga shkollat e tyre përkatëse, nëse e konsiderojnë të dobishëm për të gjetur një punë, nëse kanë pasur qasje në këshilla për karrierë, nëse janë të punësuar, dhe sa kohë iu desh për t'u punësuar, ndër të tjera. Interpretimi i rezultateve bazohet në karakteristikat demografike dhe nëse shkolla në të cilën u diplomuan të intervistuarit është partner i EYE apo jo.

### 1. PROFILI I TË ANKETUARVE

Shpërndarja gjinore e të diplomuarve të arsimit profesional që u anketuan ishte 53% burra dhe 47% gra. Duhet të theksohet se kishte disa shkolla dhe profile që kishin më shumë burra të diplomuar se sa gra të diplomuara, por ne i synuam gratë e reja aty ku ishte e mundur në mënyrë që të shihnim nëse ka dallime gjinore në aftësim dhe në mundësitë e punësimit. Më shumë se gjysma e të anketuarve ishin 19 vjeç (57%), ndërsa 26% ishin 20 vjeç, 15% ishin 18 vjeç dhe vetëm 3% ishin 21 vjeç. Shumica e të diplomuarve të arsimit profesional të anketuar ishin shqiptarë (95.4%), 1.4% ishin boshnjakë, 1.4% ishin egjiptianë, 0.6% ishin romë, 0.6% ishin turq dhe 0.2% ishin goranë, ndërsa 0.4% nuk e zbuluan përkatësinë e tyre etnike.

Figura 13 Të diplomuarit AP sipas gjinisë Figura 14 Të diplomuarit AP sipas moshës Figura 15 Të diplomuarit AP sipas etnisë



Më shumë se gjysma e të anketuarve të kësaj ankete banojnë në zona rurale dhe 47% banojnë në zona urbane. Rreth 21% e të anketuarve jetojnë në rajonin e Prizrenit, 20% jetojnë në rajonin e Prishtinës, nga 14% jetojnë në rajonin e Pejës dhe Gjakovës, 13% në rajonin e Gjilanit, 10% në rajonin e Ferizajt, dhe 7% në rajonin e Mitrovicës.

Figura 16 Të diplomuarit e AP sipas vendbanimit






Figura 17 Të diplomuarit e AP sipas rajonit



Pjesa më e madhe e të diplomuarve të arsimit profesional kanë të ardhura mujore familjare nga 400-799 euro në muaj (40%), ndërsa pothuajse një e pesta e tyre kanë të ardhura mujore familjare deri në 399 euro (19%). Rreth 14% e të diplomuarve të arsimit profesional kanë të ardhura mujore familjare që variojnë nga 800-1199 euro dhe vetëm 1% më shumë se 1200 euro.

Figura 18 Të diplomuarit AP sipas të ardhurave mujore familjare



## 2. LLOJI I TRAJNIMIT DHE KËNAQSHMËRIA ME TRAJNIMIN

Ky seksion i anketës pyeti për opinionet e të diplomuarve të arsimit profesional në lidhje me ritmin dhe dobinë e programeve që ata ndoqën në shkollat e tyre përkatëse.

Rreth tre të katërtat e të anketuarve kanë diplomuar nga shkollat e tyre përkatëse në vitin akademik 2019/2020 (72%), ndërsa 28% e tyre në vitin akademik 2018/2019. Kur u pyetën për ritmin e trajnimit (programit), 57% e të gjithë të diplomuarve nuk e konsideruan atë as të shpejtë, as të ngadaltë dhe rreth 42% e konsideruan atë si shumë të shpejtë.

Figura 19 Viti i diplomimit





Figura 20 Ritmi i trajnimit



Lidhur me dobinë e njohurive të marra gjatë programit që ata ndoqën, katër në pesë persona i konsideruan njohuritë si shumë të dobishme/të dobishme, ndërsa 17% ishin neutral, dhe 4% i konsideruan ato shumë të padobishme/të padobishme. Më shumë të diplomuar nga shkollat partnere të EYE (82%) sesa ata nga shkollat jo partnere të EYE (76%) ishin të mendimit se njohuritë që ata morën janë shumë të dobishme/të dobishme. Më shumë gra të reja (84%) sesa burra të rinj (76%) gjithashtu i konsideruan njohuritë e fituara gjatë shkollës si shumë të dobishme/të dobishme.

Kur u pyetën për aftësitë praktike të fituara gjatë shkollës, 77% e të anketuarve të diplomuar të arsimit profesional besuan se ishin shumë të dobishme/të dobishme, 19% ishin neutral, dhe 4% besuan se ishin shumë të padobishme/të padobishme. Edhe në këtë drejtim, më shumë të diplomuar të shkollave partnere të EYE (80%) dhe më shumë gra të reja (80%) i konsideruan aftësitë e fituara si shumë të dobishme/të dobishme sesa ato të shkollave jo partnere të EYE (74%) dhe burrave të rinj (75%).

Figura 21 Dobia e njohurive të fituara gjatë shkollës






Figura 22 Dobia e aftësive të fituara gjatë shkollës



Atyre që i konsideruan njohuritë të dobishme iu kërkua të shtjellonin më tej arsyet e një mendimi të tillë. Një e treta e këtyre të anketuarve konsideruan se gjërat që mësuuan i përshtaten kërkesave të tregut të punës (32%), nga rreth 21% menduan se mësuesit ishin të mirë dhe profesionistë, si dhe se literatura e përdorur ishte aktuale. Më pak të anketuar menduan se programi ishte i dobishëm për shkak të mundësisë për të gjetur një punë falë shkollës që ndoqën (13%) dhe për shkak të faktit se klasa kishte pajisje të mjaftueshme gjatë orëve praktike (4%).

Situata është e ngjashme për të diplomuarit e shkollave partnere të EYE dhe shkollave jo partnere të EYE ku më shumë të anketuar nga grupi i fundit besojnë se njohuritë të cilat i kanë fituar i përshtaten tregut të punës, se kishin mësues profesionistë dhe tekstet shkollore ishin moderne (33% kundrejt 31%; 22% kundrejt 20%, 23% kundrejt 19%, respektivisht). Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për punësimin, më shumë të diplomuar nga shkollat partnere të EYE sesa ata nga shkollat jo partnere të EYE arritën të gjejnë një punë falë programit në të cilin ishin regjistruar (16% kundrejt 9% respektivisht).

Figura 23 Arsyet prapa konsiderimit të njohurive si shumë të dobishme/të dobishme




Ngjashëm, të diplomuarve të arsimit profesional që besonin se aftësitë praktike ishin shumë të dobishme ose të dobishme, iu kërkua të shpjegonin arsyet për këtë. Pothuajse një në katër pohoi se gjërat që mësuan i përshtaten kërkesave të tregut të punës (23%), rreth 21% pohuan se mësuesit ishin të mirë dhe profesionistë, 20% se klasa kishte pajisje të mjaftueshme gjatë orëve praktike dhe 19% pohuan se literatura e përdorur ishte aktuale. Më pak të anketuar arritën të gjejnë një punë për shkak të programit që ndoqën (14%).

Kur merren parasysh dobiet e aftësive, më shumë gra sesa burra i konsideruan aftësitë shumë të dobishme/të dobishme për shkak të literaturës së përditësuar (24% kundrejt 15%), dhe për shkak të qasjes në pajisje të mjaftueshme gjatë orëve praktike (23% kundrejt 17%). Sidoqoftë, më shumë burra i konsideruan aftësitë si shumë të dobishme/të dobishme për shkak se u përshtatnin kërkesave të tregut të punës (24% kundrejt 22%), kishin mësues të mirë dhe profesionistë (22% kundrejt 19%) dhe arritën të gjenin një punë (19% kundrejt 9%).

Kur merren parasysh dallimet në bazë të shkollave të ndjekura, më shumë të diplomuar nga shkollat jo partnere të EYE sesa ata të shkollave partnere të EYE deklaruan se aftësitë ishin të dobishme pasi që aftësitë që ata mësuan i përshtaten tregut të punës (26% kundrejt 21%), literatura e përdorur ishte e përditësuar (22% kundrejt 18%) dhe se kishte pajisje të mjaftueshme gjatë orëve praktike (21% kundrejt 19%). Ndërsa më shumë të diplomuar nga shkollat partnere të EYE në krahasim me shkollat jo partnere të EYE i konsideruan mësuesit si profesionistë për aftësitë që kanë mësuar (22% kundrejt 19%) dhe se ata arritën të gjejnë një punë për shkak të aftësive të mësuara në shkollën që ndoqën (17% kundrejt 10%).

Figura 24 Arsyet prapa konsiderimit të shkathtësive si shumë të dobishme/të dobishme



Shumë pak të diplomuar (19 prej tyre) besuan se njohuritë dhe aftësitë e fituara ishin shumë të padobishme ose të padobishme në programet që ndoqën gjatë shkollës së mesme. Shumica e tyre i konsideruan të padobishme si njohuritë ashtu edhe aftësitë praktike për shkak të pamundësisë për të gjetur punë me diplomën që morën (12 dhe 11 të anketuar respektivisht). Një numër i vogël konsideruan se njohuritë dhe aftësitë ishin të padobishme për shkak të gjërave të mësuara që nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës (respektivisht 3 dhe 2 të anketuar), literatura ishte e vjetërsuar (1 i anketuar respektivisht), dhe mësuesit nuk ishin mjaft të mirë dhe profesionistë (2 dhe 1 të anketuar respektivisht). Vetëm dy të anketuar konsideruan se aftësitë ishin të padobishme për shkak të mungesës së pajisjeve të mjaftueshme gjatë orëve praktike.

Tabela 5 Arsyet prapa konsiderimit të njohurive si shumë të padobishme/të padobishme

|   |    |
|---|----|
| Nuk kam arritur të gjejë punë me drejtimin / programin që kam ndjekur | 12 |
| Mësimet që kam marrë nuk përshtaten me kërkesat që ka tregu i punës   | 3  |
| Literatura nga e cila kam mësuar ka qenë e vjetruar (jo-aktuale)      | 1  |
| Mësimdhënësit nuk ishin të mirë dhe profesional sa duhet              | 2  |
| Mungesa e pajisjeve gjatë orëve praktike                              | 0  |
| Tjetër  | 1  |
| Refuzoj të përgjigjem/Pa përgjigje                                    | 0  |
| Total   | 19 |

Tabela 6 Arsyet prapa konsiderimit të shkathtësive si shumë të dobishme/të dobishme

|   |    |
|---|----|
| Nuk kam arritur të gjejë punë me drejtimin / programin që kam ndjekur | 11 |
| Mësimet që kam marrë nuk përshtaten me kërkesat që ka tregu i punës   | 2  |
| Literatura nga e cila kam mësuar ka qenë e vjetruar (jo-aktuale)      | 1  |
| Mësimdhënësit nuk ishin të mirë dhe profesional sa duhet              | 1  |
| Mungesa e pajisjeve gjatë orëve praktike                              | 2  |
| Tjetër  | 2  |
| Refuzoj të përgjigjem/Pa përgjigje                                    | 0  |
| Total   | 19 |

Kur të njëjtët të diplomuar të arsimit profesional u pyetën se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar cilësinë e mësimave në shkollë, nëntë të anketuar sugjeruan ofrimin e më shumë orëve praktike në kompani të ndryshme, pesë të anketuar sugjeruan përdorimin e teksteve shkollore moderne, katër sugjeruan përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, tre sugjeruan përmirësimin e kushteve të


kabineteve. Tre të tjerë deklaruan se problemet nuk qëndrojnë në cilësinë e mësimdhënies por në 'profilin' që ata zgjedhën se nuk mund të gjejnë punë në tregun e punës të Kosovës pa marrë edhe një diplomë fakulteti.

Tabela 7 Sugjerime për të përmirësuar cilësinë e mësimëve

|   |    |
|---|----|
| Të ofrohen më shumë orë praktike nëpër kompani / ndërmarrje | 9  |
| Të rishkruhen librat / të ndryshojë literatura              | 5  |
| Të përmirësohet cilësia e mësimdhënies                      | 4  |
| Të përmirësohen kushtet e kabineteve                        | 3  |
| Tjetër  | 3  |
| Refuzoj të përgjigjem/Pa përgjigje                          | 3  |
| Total   | 19 |

Të gjithë të diplomuarit e arsimit profesional u pyetën më tej se sa përfituan profesionalisht nga programi që ndoqën, me ç'rast 40% e tyre thanë se kishin përfituar shumë, 42% pohuan se kishin përfituar deri diku, 15% pohuan se nuk përfituan shumë, dhe 3% mendojnë se nuk përfituan fare. Kur krahasojmë të diplomuarit e arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE dhe shkollat jo partnere të EYE, 43% e të parëve dhe 35% të këtyre të fundit deklaruan se përfituan shumë nga programi që ndoqën, ndërsa përkatësisht 37% dhe 50% pohuan se kishin përfituar deri diku në aspektin profesional. Ndërsa, kur krahasojmë gratë dhe burrat, 44% e grave dhe 36% e burrave pohuan se kanë përfituar shumë nga programi që kanë ndjekur profesionalisht, dhe 41% dhe 44% thonë se kanë përfituar deri diku.


Figura 25 Përfitimet profesionale nga programi i ndjekur



Lidhur me përfitimet në aspektin financiar, vetëm rreth 8% e të diplomuarve të arsimit profesional deklaruan se kanë përfituar shumë nga programi dhe rreth 23% pohuan se kanë përfituar deri diku. Megjithatë, rreth 23% thanë se nuk përfituan edhe aq dhe rreth 46% pohuan se nuk përfituan aspak financiarisht nga programi që ndoqën. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional të shkollave partnere të EYE sesa ata nga shkollat jo partnere të EYE përfituan shumë ose deri diku financiarisht nga programi që ndoqën (10% kundrejt 5% dhe 28% dhe 17% respektivisht). Më shumë burra sesa gra

pohuan gjithashtu shumë ose disa përfitime financiare nga programet që ndoqën (11% kundrejt 3% dhe 24% kundrejt 22% respektivisht).

Figura 26 Përfitimet financiare nga programi i ndjekur




### 3. PUNËSIMI AKTUAL DHE MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Ky seksion i anketës eksploroj statusin aktual të punësimit të të diplomuarve të arsimit profesional dhe perceptimet e tyre në lidhje me mundësitë e punësimit në Kosovë dhe pritjet për të ardhmen e karrierës së tyre profesionale.


Rreth 41% e të diplomuarve të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE dhe 31% e të diplomuarve të arsimit profesional nga shkollat jo partnere të EYE-së ishin të punësuar me orar të plotë. Rreth 27% dhe 22% e secilit ishin të papunë. Disa të diplomuar të arsimit profesional kishin vazhduar arsimin e mëtejshëm dhe kështu 23% e të diplomuarve të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE dhe 42% e shkollave jo partnere të EYE ishin studentë. Më pak të diplomuar të arsimit profesional të të dy grupeve ishin të vetëpunësuar (respektivisht 4% dhe 2%) dhe akoma më pak të punësuar me kohë të pjesshme (1% secili), ose praktikantë të papaguar (0% dhe 1% respektivisht).

Figura 27 Statusi i punësimit i të diplomuarve të AP



Për më tepër, të dhënat për punësimin të ndara sipas rajoneve tregojnë se më shumë se gjysma e të diplomuarve të arsimit profesional janë të punësuar në rajonin e Gjilanit (52%) dhe Gjakovës (54%), dhe më pak në Pejë (27%) dhe në Mitrovicë (37%).<sup>6</sup>

Figura 28 Statusi i punësimit i të diplomuarave të AP sipas rajonit



Në përgjithësi, 73% e të diplomuarve të arsimit profesional u informuan përmes familjes, miqve ose të njohurve për punët që ata mbajnë aktualisht, 8% nga njoftimet e faqeve zyrtare të kompanive, 6% u informuan përmes Facebookut, 5% përmes qendrës së karrierës së shkollës së tyre, 4% përmes Instagramit, dhe 1% përmes fletushkave fizike të reklamave të punës.

Rreth 69% e të diplomuarve të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE dhe 79% e atyre nga shkollat jo partnere të EYE u informuan për punët e tyre aktuale nga familjet, miqtë dhe të njohurit e tyre, ndërsa më pak të diplomuar të secilit grup u informuan përmes faqeve zyrtare të punëdhënësit të tyre (11% kundrejt 3%), Facebookut (7% kundrejt 4%), qendrës së karrierës së shkollës së tyre (6% kundrejt 3%), Instagramit (2% kundrejt 6%), njoftimeve në fletushkat fizike të reklamave të vendeve të punës (1% secila) dhe Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (1% secila). Ndërsa vetëm një pjesë e të diplomuarve të shkollave jo partnere të EYE përdorën portale të punës (1%).

Përveç kësaj, 76% e burrave dhe 64% e grave gjithashtu gjejnë punë përmes informatave nga familjet, miqtë dhe të njohurit. Disa gra përdorën portale pune (2%) ndërsa asnjë nga burrat nuk i përdori ato. Gratë gjithashtu përdorën mediat sociale më shumë se burrat (12% Instagram dhe 8% Facebook kundrejt 0% dhe 5%). Më shumë burra sesa gra përdorën uebfaqe zyrtare të institucionit (8% kundrejt 7%) dhe qendrat e karrierës së shkollës së tyre (6% kundrejt 2%).

<sup>6</sup> Kategoria e të punësuarve për këtë grafik përfshinte të diplomuarit e arsimit profesional që janë të punësuar me orar të plotë ose të pjesshëm dhe ata që janë të vetëpunësuar.

Figura 29 Kanalet e informimit për punën aktuale, \*vetëm një përgjigje


|   | Burrë | Grua | Partnerë EYE | Jo Partner EYE | Totali |
|---|-------|------|--------------|----------------|--------|
| Informatat nga miqtë / familja            | 76%   | 64%  | 69%          | 79%            | 73%    |
| Njoftimet nga faqet zyrtare të...         | 8%    | 7%   | 11%          | 3%             | 8%     |
| Facebook                                  | 5%    | 8%   | 7%           | 4%             | 6%     |
| Pëmes qendrës së karrierës së shkollës... | 6%    | 2%   | 6%           | 3%             | 5%     |
| Instagram                                 | 0%    | 12%  | 2%           | 6%             | 4%     |
| Other, please specify                     | 2%    | 0%   | 2%           | 0%             | 2%     |
| Fletushkat                                | 1%    | 2%   | 1%           | 1%             | 1%     |
| Njoftimet nga Agjensia e Punësimit        | 1%    | 2%   | 1%           | 1%             | 1%     |
| Portalet e punës                          | 0%    | 2%   | 0%           | 1%             | 1%     |
| Reklamat                                  | 0%    | 2%   | 1%           | 0%             | 1%     |
| Not applicable                            | 1%    | 0%   | 1%           | 0%             | 1%     |
| LinkedIn                                  | 0%    | 0%   | 0%           | 0%             | 0%     |
| Refuse to answer / No answer              | 0%    | 0%   | 0%           | 0%             | 0%     |

Rezultatet tregojnë se pothuajse të gjithë të anketuarit e punësuar kanë gjetur një punë brenda 24 muajve, pa ndonjë ndryshim të atyre që kishin vijuar shkollat partnere të EYE dhe ato jo partnere të EYE. Ekziston një ndryshim i vogël sipas gjinisë, ku të gjithë burrat kanë gjetur punë brenda 24 muajve në krahasim me 98% të grave.

Më shumë se gjysma e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional (54%) që janë të punësuar me orar të plotë ishin në gjendje të gjenin një punë brenda 0-3 muajve, 24% ishin në gjendje të gjenin një punë brenda 4-6 muajve, 9% brenda 7-9 muajve, dhe 13% brenda 10-24 muajve. Kur krahasojmë të diplomuarit e arsimit profesional të shkollave partnere EYE dhe shkollave jo partnere të EYE, 53% e të parëve dhe 56% e këtyre të fundit gjetën punë brenda 0-3 muajve, 20% dhe 31% respektivisht gjetën punë brenda 4-6 muajve, 11% dhe 4% respektivisht brenda 7-9 muajve, dhe 16% dhe 9% respektivisht brenda 10-24 muajve.

Tutje, rreth dy të tretat e burrave të rinj të punësuar dhe rreth një e treta e grave të reja të punësuar ishin punësuar brenda 0-3 muajve. Ndërkohë, 18% e burrave të rinj dhe 37% e grave të reja u punësuan brenda 4-6 muajve, 8% dhe 10% respektivisht brenda 7-9 muajve, dhe 12% dhe 19% respektivisht brenda 10-24 muajve.


Figura 30 Koha që u desh për të gjetur një punë që nga diplomimi, \* vetëm të diplomuarit e AP -së të punësuar



Në përgjithësi, 39% e të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2018/2019 dhe 38% e të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2019/2020 janë të punësuar. Prandaj, është e rëndësishme të kuptohet se sa kohë iu deshën vetëm të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2018/2019 dhe të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2019/2020 vetëm për t'u punësuar. Rreth 52% e të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2018/2019 gjetën punë brenda 0-3 muajve, 20% brenda 4-6 muajve, 8% brenda 7-9 muajve, 10% brenda 10-12 muajve, 3% brenda 16-18 muajve, 2% brenda 19-21 muajve, 3% brenda 22-24 muajve, dhe 2% brenda më shumë se 24 muajve.

Ndërsa, 55% e të diplomuarve të arsimit profesional të vitit 2019/2020 gjetën punë brenda 0-3 muajve, 25% brenda 4-6 muajve, 9% brenda 7-9 muajve dhe 11% brenda 10-12 muajve.

Figura 31 Koha që u desh për të gjetur një punë që nga diplomimi, \* vetëm të diplomuarit e AP -së të punësuar sipas vitit të diplomimit



Kishte kohëzgjatje të ndryshme që iu deshën të diplomuarve për të gjetur një punë sipas profesionit që kishin marrë nga shkolla e mesme. Për shkak të numrit të vogël të të anketuarve për profil, koha që iu desh të diplomuarve të arsimit profesional bazuar në profilin e trajnimit u grupua në 0-3 muaj, 4-6 muaj dhe më shumë se 6 muaj. Këto rezultate janë vetëm indikative pasi mostra nuk është përfaqësuese e profileve të trajnimit.

Nga ata të diplomuar të arsimit profesional, 38% e atyre në fushat e *Administratës* gjetën punë brenda 0-3 muajve, 13% brenda 4-6 muajve dhe 50% në më shumë se 6 muaj. Të gjithë ata të diplomuar që u punësuan dhe u diplomuan në fushat e *Arkitekturës* gjetën punë brenda 0-3 muajve. Tutje, 79% e atyre në fushat *Auto mekanike* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 7% brenda 4-6 muajve dhe 14% në më shumë se 6 muaj. Gjithsej 62% e të diplomuarve në fushat e *Shkencave Kompjuterike/IT* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 15% brenda 4-6 muajve dhe 23% në më shumë se 6 muaj. Ndërsa, 43% e të diplomuarve në fushat e *Ndërtimit* gjetën punë brenda 0-3 muajve dhe 57% brenda 4-6 muajve. Për më tepër, 40% e të anketuarve të diplomuar në fushat *Ekonomi/Tregti/Shitje/Marketing* gjetën punë brenda 0-3 muajve, 40% brenda 4-6 muajve dhe 20% në më shumë se 6 muaj.

Për më tepër, 40% e të diplomuarve në fushat *Banka/Financa/Kontabilitet/Sigurim* gjetën punë brenda 0-3 muajve, 40% brenda 4-6 muajve dhe 20% në më shumë se 6 muaj. Ndërsa, 52% në fushat e *Dizajnit të Modës/Dizajn i Brendshëm/Dizajn Grafik* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 19% brenda 4-6 muajve


dhe 34% në më shumë se 6 muaj. Rreth 50% e të diplomuarve në fushat e *Teknologjisë Ushqimore* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 19% brenda 4-6 muajve dhe 34% në më shumë se 6 muaj. Gjithsej 22% e të diplomuarve në fushat e *Bujqësisë/Agrobiznesit/Hortikulturës* gjetën punë brenda 0-3 muajve dhe 78% brenda 4-6 muajve.

Më tej, 60% e të diplomuarve në fushat e *Rrobaqepësisë* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 20% brenda 4-6 muajve dhe 20% në më shumë se 6 muaj. Ndërsa, 80% në fushat e *Punës me Metal* gjetën punë brenda 0-3 muajve, dhe 20% në më shumë se 6 muaj. Më shumë se gjysma (55%) e të diplomuarve në fushat *Juridike* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 9% brenda 4-6 muajve dhe 34% në më shumë se 6 muaj. Gjithsej 57% e të diplomuarve në fushat e *Postës dhe Telekomunikacionit* gjetën punë brenda 0-3 muajve, 29% brenda 4-6 muajve dhe 14% në më shumë se 6 muaj.

Për më tepër, 63% e të diplomuarve në *Transportin rrugor/Trafikun rrugor/Fushat e drejtimit të trenit* gjetën punë brenda 0-3 muajve, 13% brenda 4-6 muajve dhe 25% në më shumë se 6 muaj. Ndërsa, 67% në fushat *Hidraulike* gjetën punë brenda 0-3 muajve, 17% brenda 4-6 muajve dhe 17% në më shumë se 6 muaj. Të gjithë të diplomuarit në fushat e *Makinerisë* gjetën punë në 0-3 muaj. Një pjesë e 43% e të diplomuarve në fushat e *Prodhimit* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 14% brenda 4-6 muajve dhe 43% në më shumë se 6 muaj. Të gjithë të diplomuarit në fushat e *Veterinarisë* gjetën punë brenda 4-6 muajve. Dhe, të gjithë të diplomuarit në fushat e *Menaxhimit të Hoteleve dhe Turizmit* gjetën punë brenda 0-3 muajve.

Dhe në fund, 56% e të diplomuarve në fushat e *Energjisë/Instalimeve Elektrike/Ngrohjes dhe Kondicionimit* gjetën një punë brenda 0-3 muajve, 20% brenda 4-6 muajve dhe 24% në më shumë se 6 muaj. Ndërsa, të gjithë të diplomuarit në fushat e *Kimisë* gjetën punë brenda 4-6 muajve.

Figura 32 Koha që u desh për të gjetur një punë që nga diplomimi, \* vetëm të diplomuarit e AP -së të punësuar sipas profilit të trajnimit




Kur u pyetën për sektorin e punësimit, të diplomuarit duhej të tregonin nëse janë të punësuar në sektorin privat (formal), sektorin joformal (privat), apo sektorin publik. Në përgjithësi, 77% e të diplomuarve të arsimit profesional janë të punësuar në sektorin privat formal dhe 20% e tyre në sektorin privat joformal, ndërsa 3% në sektorin publik.

Vlen të përmendet se 70% e të diplomuarve të arsimit profesional të shkollave partnere EYE dhe 90% e të diplomuarve të arsimit profesional të shkollave jo partnere të EYE punojnë në sektorin privat formal, ndërsa 25% dhe 10% e secilit respektivisht punojnë në sektorin privat joformal. Rreth 5% e të diplomuarve të arsimit profesional të shkollave partnere të EYE punojnë në sektorin publik dhe asnjë nga të diplomuarit e shkollave jo partnere të EYE nuk punon atje. Më shumë gra të reja sesa burra të rinj janë të punësuar në sektorin privat formal (83% kundrejt 74%) sesa në sektorin privat joformal (13% kundrejt 22%). Rreth 3% nga secili grup punon në sektorin publik.


Sa i përket sektorit ku bëjnë praktikë, vetëm katër persona nga 500 të anketuar ishin duke bërë praktikë, dy në sektorin privat formal, një në sektorin privat joformal dhe një në sektorin publik (nuk është paraqitur në grafik).

Figura 33 Sektori i punësimit i të diplomuarve të AP-së




Më pak se gjysma e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional (45%) të cilët janë të punësuar ose duke bërë praktikë pohuan se puna që ata kanë lidhet me aftësitë e fituara gjatë shkollave të tyre të mesme profesionale, ndërsa 55% pohuan të kundërtën. Më pak të diplomuar nga shkollat partnere të EYE sesa shkollat jo partnere të EYE besojnë se puna e tyre lidhet me aftësitë e programit të vijuar gjatë shkollave të mesme (43% kundrejt 48% respektivisht) dhe më pak burra sesa gra pretendojnë të njëjtën gjë (44% kundrejt 45% respektivisht).

Figura 34 Lidhja e punës/praktikës me aftësitë e fituara gjatë shkollimit profesional




Shumica e të diplomuarve të papunë të arsimit profesional (84%) planifikojnë të kërkojnë punë në të ardhmen dhe 10% e tyre nuk planifikojnë. Rreth 80% e të diplomuarve në shkollat partnere të EYE dhe 90% e shkollave jo partnere të EYE planifikojnë të kërkojnë punë dhe 80% e burrave dhe 89% e grave planifikojnë të kërkojnë punë në të ardhmen.

Figura 35 Planet për kërkimin e një pune \*të diplomuarit e AP të papunë, studentë ose praktikantë



Kur u pyetën nëse kishin kërkuar punë që nga përfundimi i shkollës së mesme, 66% e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional pohuan se kishin kërkuar dhe 34% jo. Rreth 68% e të diplomuarve të shkollave partnere të EYE dhe 61% e shkollave jo partnere të EYE deklaruan se kanë kërkuar punë që nga mbarimi i shkollës së mesme. Ndërsa kur krahasohen sipas gjinisë, 70% e burrave dhe 63% e grave kanë kërkuar punë që kur diplomuan.

Figura 36 Kërkimi i punës që nga fundi i shkollës së mesme, \*vetëm të diplomuarit e AP-së të papunë




Atyre që nuk kërkuar punë që nga mbarimi i shkollës së mesme (n=42) iu kërkua të shtjellojnë arsyet për këtë. Në përgjithësi, 28% e tyre pohuan se po studiojnë dhe nuk kanë kohë për të punuar, nga afro 8% e tyre nuk besojnë se do të gjejnë punë, nuk duan të punojnë për rroga të ulëta, duhet të kujdesen për punët e shtëpisë dhe familjen, ndërsa 5% nuk duan të punojnë dhe 3% marrin të ardhura nga familja jashtë vendit.

Duhet të theksohet se kur krahasojmë të rinjtë dhe të rejat, më shumë burra (11%) pohojnë se nuk duan të punojnë për një pagë të ulët sesa gratë (5%), ndërsa më shumë gra (10%) sesa burrat (5%) nuk besojnë se do të gjejnë punë. Vlen të theksohet se 15% e grave që nuk kërkojnë punë duhet të kujdesen


për punët e shtëpisë dhe familjen dhe asnjë nga burrat nuk e ka përmendur një gjë të tillë si arsye për mos kërkim të punës.

Figura 37 Arsyet për mos kërkimin e një pune, \*vetëm ata që nuk kanë kërkuar punë që nga mbarimi i shkollës së mesme



Pothuajse gjysma e atyre që aplikuan për punë që nga mbarimi i shkollës së mesme (49%) aplikuan në 1-3 vende pune deri më tani (deri në qershor 2021). Rreth 36% aplikuan në 4-6 vende pune, 3% në 7-9 vende pune dhe rreth 9% në më shumë se 9 vende pune. Rreth 54% e të diplomuarve të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE aplikuan në 1-3 vende pune dhe 50% e të diplomuarve të arsimit profesional të shkollave jo partnere të EYE aplikuan në 4-6 vende pune. Ndërsa ka më pak dallime kur merret parasysh gjinia ku 56% e grave të reja dhe 40% e burrave të rinjve aplikuan për 1-3 vende pune. Është befasuese që 17% e burrave aplikuan në më shumë se 9 vende pune ndërsa vetëm 2% e grave aplikuan në aq shumë vende pune.

Figura 38 Numri mesatar i vendeve të punës në të cilat kanë aplikuar, \*vetëm ata që kanë aplikuar për punë që nga mbarimi i shkollës së mesme




Në përgjithësi, 53% e të diplomuarve të arsimit profesional u informuan përmes familjes, miqve ose të njohurve për punët në të cilat aplikuan, 12% u informuan përmes Facebookut, 9% nga njoftimet e faqeve zyrtare të kompanive, dhe nga 6% përmes portaleve të punës dhe Instagramit.

Të diplomuarit e arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE (61%) mbështeten më shumë tek familjet, miqtë dhe të njohurit lidhur me mundësitë e punës në krahasim me shkollat jo partnere të EYE (39%). Praktikisht asnjë nga të parët nuk mbështetet në portalet e punës për mundësi punësimi krahasuar me 18% të këtyre të fundit.


Duke krahasuar rezultatet mes burrave dhe grave, rreth tre në katër burra dhe pak më shumë se një në tri gra mbështeten tek familjet, miqtë dhe të njohurit për informata rreth punës. Shumë më tepër gra sesa burra përdorin portale pune (9% vs.3%), Instagram (9% vs.3%), Facebook (18% vs.3%) dhe uebfaqe të kompanive (14% kundrejt 3%).

Figura 39 Kanalet e informimit për vendet e punës në të cilat kanë aplikuar që nga diplomimi, \*deri në tri zgjedhje




Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, e njohur ndryshe si Portali i Punës së Kosovës, është një portal kombëtar i punës i cili synon të ndërmjetësojë tregun e punës dhe të zbatojë politikat e punësimit dhe aftësimin profesional. Qytetarët e Kosovës mund të regjistrohen në portal dhe të informohen lidhur me mundësi të reja të punës. Prandaj, anketa tutje pyeti të diplomuarit e arsimit profesional nëse ata janë të regjistruar si punëkërkuar në portalin APRK, duke rezultuar në 91% të tyre që deklarojnë se nuk janë të regjistruar dhe 6% e tyre janë regjistruar aty, ndërsa 3% e tyre nuk e dinin se agjencia ekzistonte. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional të shkollave partnere të EYE sesa shkollave jo partnere të EYE janë regjistruar në të (respektivisht 8% dhe 4%). Më shumë burra sesa gra janë regjistruar gjithashtu në Portalin e Punës të Kosovës (8% dhe 5% respektivisht).

Figura 40 Regjistrimi i të diplomuarve të AP -së në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës




Edhe pse një numër i vogël i të anketuarve ishin regjistruar në APRK, ata u pyetën nëse ishin këshilluar për mundësitë e punësimit nga agjencia, dhe 65% e tyre deklaruan se po. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional të shkollave partnere të EYE sesa shkollave jo partnere të EYE ishin këshilluar nga agjencia (75% kundrejt 43%). Më shumë gra sesa burra ishin këshilluar nga agjencia gjithashtu (70% kundrejt 62%).

Figura 41 Këshilla për mundësitë e punësimit nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës




I njëjti grup i të diplomuarve më pas u pyet nëse ishin njoftuar ndonjëherë për një vend të lirë pune nga APRK. Rreth 57% e të gjithë atyre deklaruan se po, ndërsa 43% nuk u njoftuan kurrë për një vend pune. Rreth 69% e të diplomuarve të shkollave partnere EYE u njoftuan ndërsa vetëm 29% e atyre nga shkollat jo partnere të EYE. Nga ana tjetër, 62% e burrave dhe 50% e grave u njoftuan për një vend pune nga APRK.

Figura 42 Njoftimet për konkurse të punës nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës




Të gjithë të diplomuarit e arsimit profesional u pyetën nëse kanë aplikuar për ndonjë punë në 6 muajt e fundit për të kuptuar nëse ata që janë të punësuar po kërkojnë mundësi të reja apo ata të papunët po kërkojnë punë në mënyrë aktive. Vetëm 34% e tyre kanë aplikuar për punë në 6 muajt e fundit. Pothuajse pjesë të njejta të të diplomuarve të shkollave partnere të EYE dhe shkollave jo partnere të EYE aplikuan për punë në këtë periudhë (35% dhe 33% respektivisht). Konsiderueshëm më tepër gra sesa burra aplikuan për punë në gjashtë muajt e fundit (42% dhe 28% respektivisht).

Figura 43 Aplikimet për punë të të gjithë të diplomuarve të AP -së në 6 muajt e fundit




Të diplomuarit e arsimit profesional më pas u pyetën nëse aplikuan për punë në 12 muajt e fundit. Më shumë prej tyre (40%) kanë aplikuar për punë në 12 muajt e fundit. Vetëm pak më shumë të diplomuar të shkollave partnere të EYE sesa shkollave jo partnere të EYE aplikuan për punë në një periudhë 12-mujore (41% dhe 38% respektivisht). Edhe brenda periudhës një vjeçare, më shumë gra sesa burra aplikuan për punë (47% dhe 33% respektivisht).

Figura 44 Aplikimet për punë të të gjithë të diplomuarve të AP -së në 12 muajt e fundit



Me dixhitalizimin e shumë proceseve përfshirë punën dhe me shumë njerëz që po punojnë nga shtëpia gjatë pandemisë COVID-19, ishte e rëndësishme të pyesim më tej të diplomuarit e arsimit profesional se si aplikuan për këto punë brenda 6 dhe 12 muajve. Më shumë se gjysma e tyre kishin aplikuar në mjediset fizike të punëdhënësve, 40% kishin aplikuar herë fizikisht, herë online dhe vetëm 8% e tyre kishin aplikuar për punë vetëm online.


Figura 45 Mënyra e aplikimit e të gjithë të diplomuarve të AP -së



Të diplomuarve të arsimit profesional iu kërkua që të pajtoheshin ose të mos pajtoheshin me një deklaratë rreth mundësisë së gjetjes së një pune brenda 12 muajve. Në të vërtetë, 38% ishin neutral në


lidhje me perspektivat e gjetjes së një pune në 12 muajt e ardhshëm, 44% u pajtuan/u pajtuan plotësisht se do të mund të gjenin punë në atë periudhë, dhe 14% nuk u pajtuan aspak. Rreth 3% thanë se nuk do të aplikojnë për një punë. Më shumë të diplomuar të shkollave jo partnere të EYE janë të sigurt për perspektivat e punësimit në 12 muajt e ardhshëm sesa të diplomuarit e shkollave partnere të EYE (52% kundrejt 38%). Po kështu, më shumë burra sesa gra besojnë se do të gjejnë një punë brenda 12 muajve (52% kundrejt 37%).

Figura 46 Pajtimi me deklaratën "Unë do të gjej një punë në 12 muajt e ardhshëm"



Të diplomuarve të arsimit profesional pastaj iu kërkua që të pajtoheshin ose të mos pajtoheshin me një deklaratë rreth mundësisë së gjetjes së një pune brenda 24 muajve. Rreth 50% u pajtuan/pajtuan plotësisht se do të gjenin një punë në 24 muajt e ardhshëm, 33% ishin neutral në këtë drejtim, dhe 11% nuk u pajtuan/nuk u pajtuan aspak. Rreth 3% thanë se nuk do të aplikojnë për një punë në 24 muajt e ardhshëm. Më shumë të diplomuar të shkollave jo partnere të EYE janë të sigurt për perspektivat e punësimit në 24 muajt e ardhshëm sesa të diplomuarit e shkollave partnere të EYE (68% kundrejt 41%). Të ndarë sipas gjinisë, më shumë burra sesa gra besojnë se do të gjejnë një punë brenda 24 muajve (60% kundrejt 45%).


Figura 47 Pajtimi me deklaratën "Unë do të gjej një punë në 24 muajt e ardhshëm"



Ishte gjithashtu e rëndësishme të eksploroheh perceptimet e të diplomuarve të arsimit profesional për të ardhmen e tyre profesionale dhe financiare. Gjithsej 54% e të diplomuarve të të arsimit profesional u pajtuan/pajtuan plotësisht se falë shkollës në të cilën ata u diplomuan i pret një e ardhme profesionale shumë e suksesshme; 28% ishin neutral në këtë drejtim, dhe 25% nuk u pajtuan/nuk u pajtuan aspak. Pak më shumë të diplomuar të shkollave partnere të EYE sesa shkollave jo partnere të EYE u pajtuan/pajtuan plotësisht që jeta e tyre profesionale në të ardhmen do të jetë e suksesshme (54% dhe


52% respektivisht). Gratë ishin më optimiste se burrat për një të ardhme të suksesshme profesionale (përkatësisht 57% dhe 50%).

Figura 48 Pajtimi me deklaratën “Falë shkollës në të cilën kam diplomuar; më pret një e ardhme profesionale shumë e suksesshme”




Lidhur me të ardhmen e suksesshme në aspektin financiar, perceptimi i të diplomuarve të arsimit profesional është pak më i keq sesa kur krahasohet me aspektin profesional. Gjithsej 50% e të gjithë të diplomuarve të arsimit profesional u pajtuan/pajtuam plotësisht se falë shkollës në të cilën ata u diplomuan, një e ardhme financiare shumë e suksesshme i pret ata, 29% ishin neutralë në këtë drejtim, dhe 26% nuk u pajtuan/nuk u pajtuam aspak. Shumë më tepër të diplomuar të shkollave partnere të EYE sesa shkollave jo partnere të EYE u pajtuan/pajtuam plotësisht që jeta e tyre financiare në të ardhmen do të jetë e suksesshme (57% dhe 41% respektivisht). Më shumë gra presin një të ardhme të suksesshme financiare sesa burrat (54% dhe 47% respektivisht).

Figura 49 Pajtimi me deklaratën “Falë shkollës në të cilën kam diplomuar; më pret një e ardhme shumë e suksesshme financiare”




Duke pasur parasysh se ekziston një nivel i lartë i papunësisë së të rinjve dhe pas eksplorimit të perceptimeve të të diplomuarve të arsimit profesional për mundësitë e punësimit, atyre më tej iu kërkua që të pohojnë ose mohojnë një deklaratë nëse duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional në Kosovë. Rreth dy të tretat e të gjithë të diplomuarve (67%) duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional në Kosovë, 22% nuk e duan këtë, dhe 11% nuk janë të sigurt nëse e duan. Më shumë të diplomuar të shkollave partnere të EYE sesa shkollave jo partnere të EYE duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional në Kosovë (69% dhe 63% respektivisht). Më shumë gra duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional në Kosovë sesa burrat (72% dhe 62% respektivisht).

Figura 50 Pajtimi me deklaratën “Në të ardhmen, dua të ushtroj aktivitetin tim profesional në Kosovë”




Edhe pse ata që thanë jo në pyetjen e mëparshme mund të nënkuptonin se ata donin të praktikonin aktivitetet e tyre profesionale jashtë Kosovës, ata gjithashtu mund të kenë nënkuptuar se ata thjesht nuk duan ta praktikojnë atë fare. Kështu, anketa kërkoi më tej që të pohohet apo mohohet një deklaratë nëse të diplomuarit e arsimit profesional duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional jashtë Kosovës. Gjithsej 53% e të gjithë të diplomuarve duan të ushtrojnë aktivitetin e tyre profesional jashtë Kosovës, 26% nuk janë të sigurt për këtë, dhe 22% nuk e duan këtë.

Figura 51 Pajtimi me deklaratën “Në të ardhmen, dua të ushtroj aktivitetin tim profesional jashtë Kosovës”




Për më tepër, të diplomuarit e arsimit profesional u pyetën për vështirësitë e gjetjes së një pune në Kosovë. Në përgjithësi, 70% e të diplomuarve besojnë se është ose e vështirë ose shumë e vështirë për të gjetur një punë në Kosovë. Rreth 20% e tyre janë neutral, dhe 10% besojnë se është e lehtë ose shumë e lehtë. Gjithsej 71% e të diplomuarve në shkollat partnere të EYE dhe 70% e shkollave jo partnere të EYE mendojnë se gjetja e një pune në Kosovë është e vështirë/shumë e vështirë. Më shumë gra sesa burra e perceptojnë gjetjen e një pune në Kosovë si të vështirë/shumë të vështirë (75% dhe 68% respektivisht).

Figura 52 Sa e vështirë mendoni se është të gjesh një punë në Kosovë?



Perceptimet e të diplomuarve të arsimit profesional në lidhje me vështirësinë e gjetjes së një pune në Kosovë në profesionin e tyre është e ngjashme me perceptimin e përgjithshëm të gjetjes së një pune në Kosovë. Në përgjithësi, 72% e të diplomuarve besojnë se është ose e vështirë ose shumë e vështirë të gjesh një punë në Kosovë në profesionin e tyre. Rreth 16% e tyre janë neutral, dhe 12% besojnë se është e lehtë ose shumë e lehtë. Rreth katër në pesë (81%) të diplomuar në shkollat jo partnere të EYE dhe 65% e atyre në shkollat partnere të EYE mendojnë se gjetja e një pune në Kosovë në profesionin e tyre është e vështirë/shumë e vështirë. Më shumë gra sesa burra e perceptojnë gjetjen e një pune në Kosovë në profesionin e tyre si të vështirë/shumë të vështirë (76% dhe 68% respektivisht).

Figura 53 Sa e vështirë mendoni se është të gjesh një punë në Kosovë në profesionin tënd?




#### 4. EFIKASITETI I TRAJNIMEVE DHE NDIKIMI TEK TË DIPLOMUARIT

Ky seksion i anketës eksploroj perceptimet e përgjithshme të të diplomuarve të arsimit profesional në lidhje me efikasitetin e trajnimit dhe ndikimin e tij tek të diplomuarit, si dhe ndihmën e marrë, nëse kanë marrë, nga qendrat e karrierës brenda shkollës.


Një pjesë e madhe e të diplomuarve të arsimit profesional (76%) i konsideruan mësimet teorike të marra gjatë shkollës së mesme profesionale si efikase ose shumë efikase. Rreth 19% e tyre ishin neutral në lidhje me efektivitetin e tyre dhe 4% i konsideruan si joefikase. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE (22%) i konsideruan mësimet teorike si shumë efikase në krahasim me të diplomuarit e shkollave jo partnere të EYE (10%), megjithëse të njëjtat pjesë i konsideruan në mënyrë kumulative si efikase/shumë efikase (nga 76%). Pak më shumë gra (78%) i konsideruan ato efikase ose shumë efikase sesa burrat (75%).

Figura 54 Efikasiteti i mësimve teorike në shkollë




Pjesa e njëjtë e të diplomuarve të arsimit profesional (76%) konsideruan se mësimet teorike kishin ndikuar pozitivisht ose shumë pozitivisht në jetën e tyre profesionale. Rreth 22% e tyre ishin neutral në lidhje me ndikimin e mësimve teorike në jetën e tyre profesionale, ndërsa 2% menduan se ndikuan negativisht. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE (18%) e konsideruan ndikimin si shumë pozitiv në krahasim me të diplomuarit e shkollave jo partnere të EYE (10%), edhe pse efekti kumulativ pozitiv ishte i njëjtë (nga 76%). Pak më shumë gra (77%) e konsideruan ndikimin e përgjithshëm si pozitiv sesa burrat (75%).

Figura 55 Ndikimi i njohurive të fituara nga mësimet teorike në jetën profesionale të të diplomuarve të AP -së




Kur u pyetën nëse i kanë vënë në përdorim njohuritë e marra përmes orëve teorike, vetëm 41% thanë se po ndërsa 58% jo. Nuk ka dallime të mëdha mes të diplomuarve të shkollave partnere të EYE dhe shkollave jo partnere të EYE (42% kundrejt 41%) kur bëhet fjalë për vënien në përdorim të këtyre njohurive; ndërsa, nuk kishte dallime gjinore në këtë drejtim.

Figura 56 Vënia në përdorim e njohurive të fituara përmes orëve teorike




Pothuajse katër në pesë të diplomuar të arsimit profesional (79%) i konsideruan mësimet praktike të marra gjatë programit të tyre në shkollën e mesme si efikase ose shumë efikase, ndërsa 20% e tyre i konsideruan ato si joefikase ose shumë joefikase. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional nga shkollat partnere të EYE (24%) i konsideruan mësimet praktike si shumë efikase në krahasim me të diplomuarit e shkollave jo partnere të EYE (17%), megjithëse më shumë nga këta të fundit i konsideruan ato në mënyrë kumulative efikase/shumë efikase sesa të parët (82% kundrejt 77%). Pak më shumë gra (78%) i konsideruan ato efikase ose shumë efikase sesa burrat (75%).

Figura 57 Efektiviteti i mësimëve praktike në shkollë




Ndikimi i njohurive të marra nga mësimet praktike në jetën profesionale të të diplomuarve të arsimit profesional duket të jetë pozitiv ose shumë pozitiv për një pjesë të konsiderueshme të tyre (73%). Rreth 26% e të diplomuarve e konsideruan ndikimin neutral dhe 1% e konsideruan atë negativ. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional nga shkollat jo partnere të EYE (74%) e konsideruan ndikimin e klasave praktike pozitive/shumë pozitive në krahasim me të diplomuarit e shkollave partnere të EYE (71%). Pak më shumë gra (74%) e konsideruan ndikimin e përgjithshëm të mësimëve praktike pozitive sesa meshkujt (71%).

Figura 58 Ndikimi i njohurive të fituara nga mësimet praktike në jetën profesionale të të diplomuarve të AP -së



Kur u pyetën nëse i kanë vënë në përdorim njohuritë e marra përmes orëve praktike, rreth 40% pohuan se po ndërsa 60% jo. Nuk ka dallime të mëdha mes të diplomuarve të shkollave partnere të EYE dhe shkollave jo partnere të EYE (40% kundrejt 41%) kur bëhet fjalë për vënien në përdorim të këtyre njohurive; ndërsa, kishte dallime më të thella gjinore, në të cilin rast 44% e burrave dhe 36% e grave pohuan se kishin vënë në përdorim njohuritë nga orët praktike.

Figura 59 Vënia në përdorim e njohurive të fituara përmes orëve praktike



Vendimet për karrierë kanë një ndikim kryesor në jetën e të rinjve, duke ndikuar në jetën e tyre profesionale, financiare dhe sociale. Kështu, shkollat e mesme dhe veçanërisht ato të fokusuar në arsimin dhe aftësimin profesional kanë një rol kyç në përgatitjen e nxënësve për të kaluar në mënyrë efektive në tregun e punës përmes udhëzimit për karrierë.

Prandaj, grupi tjetër i pyetjeve drejtuar të diplomuarve të arsimit profesional eksploroji nëse qendrat e karrierës në shkolla (QKS) i ndihmuan ata të përgatiteshin për punë të mundshme në të ardhmen. Më shumë se katër në pesë të diplomuar të arsimit profesional (83%) kanë marrë ndihmë nga qendra e karrierës së shkollës së tyre në përgatitjen e një aplikimi për punë. Pjesë të ngjashme të të diplomuarve të arsimit profesional gjithashtu konfirmuan se QKS-të e tyre i ndihmuan ata të përgatisin një letër motivimi. Nuk ka dallime domethënëse mes QKS-ve partnere të EYE dhe QKS-ve jo partnere të EYE ose mes të rinjve dhe të rejave në lidhje me këto dy elemente.

Figura 60 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen e aplikimit për punë





Figura 61 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen e letrës së motivimit



Rreth 87% e të diplomuarve të arsimit profesional janë ndihmuar nga QKS-të e tyre në përgatitjen e një CV-je. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional të shkollave jo partnere të EYE (91%) pohojnë se janë ndihmuar në përgatitjen e një CV-je sesa ata të shkollave partnere të EYE (84%). Pak më shumë gra sesa burra pohojnë të njëjtën gjë (87% kundrejt 86%). Një pjesë e madhe e të diplomuarve të arsimit profesional (82%) gjithashtu pohojnë se QKS-të e tyre i kanë ndihmuar ata të përgatiten për intervista pune. Në këtë drejtim, pak më shumë të diplomuar nga shkollat partnere të EYE (82%) sesa shkollat jo partnere të EYE (81%) pohojnë të njëjtën gjë, si dhe pak më shumë gra (82%) sesa burrat (81%).

Figura 62 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen e një CV






Figura 63 Qendra e karrierës në shkollë ndihmoi në përgatitjen për intervistat e punës




Kur u pyetën se cili ishte kursi/trajnimi më i dobishëm i marrë nga QKS-të e tyre, 38% përmendën përgatitjen e një CV-je, 14% përmendën përgatitjen për një intervistë, 12% përmendën përgatitjen e një aplikimi për punë dhe 7% përmendën përgatitjen e një letre motivimi. Zgjedhja 'e pa aplikueshme' u zgjodh nga të diplomuarit të cilët nuk kishin marrë një ndihmë/trajnim të tillë.

Figura 64 Kurse/Trajnime e mbajtura nga qendrat e karrierës në shkollë që ishin më të dobishme për të gjetur një punë



Ndikimi i njohurive të marra nga QKS-të në jetën profesionale të të diplomuarve të arsimit profesional duket të jetë pozitiv ose shumë pozitiv për një pjesë të konsiderueshme të tyre (67%). Rreth 20% e të diplomuarve e konsideruan ndikimin neutral. Më shumë të diplomuar të arsimit profesional nga shkollat jo partnere të EYE (70%) e konsideruan ndikimin e kurseve të QKS-ve pozitive/shumë pozitive në krahasim me të diplomuarit e shkollave partnere të EYE (64%). Pak më shumë burra (67%) sesa gra (66%) e konsideruan ndikimin e kurseve të QKS-ve si pozitive/shumë pozitive.

Figura 65 Ndikimi i njohurive të fituara nga qendrat e karrierës në shkollë në jetën profesionale të të diplomuarve të AP-së





# **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky raport ofron interpretimin dhe analizën e dy anketave me portalet e punës dhe të diplomuarit e shkollave publike profesionale të mesme në Kosovë, të cilat shërbejnë si studime bazë për të matur një ndër treguesit e projektit për Rritjen e Punësimit për të Rinj (EYE). Qëllimi i fazës përmbyllëse (faza III) të projektit EYE është të rrisë punësimin e grave dhe burrave të rinj në Kosovë. Përmes këtyre tri anketave ne kemi hulumtuar shkallën në të cilën është arritur ky qëllim.

EYE ka disa tregues kryesorë për Rezultatin 2. Qëllimi nën Rezultatin 2 është që gratë dhe burrat e rinj të bëjnë zgjedhje të mirinformuara për karrierën dhe të kenë më shumë mundësi punësimi përmes një sistemi të përmirësuar të informacionit të tregut të punës, i cili u tentua të matej me anketën me të diplomuarit e shkollave profesionale e cila i pyet nëse kanë gjetur punë, kur e kanë gjetur atë, dhe përmes cilës platformë; si dhe përmes anketës me portalet e punës e cila pyeti për numrin e njerëzve që gjejnë punë përmes platformave të tyre dhe grupmoshën që përdor platformat e tyre më së shumti.

Si përfundim, portalet e punës ndërmjetësojnë tregun e punës vetëm duke shërbyer si një “pikë takimi” për punëdhënësit dhe punëkërkuarit. Ato ofrojnë shërbime të ndryshme për punëdhënësit siç janë njoftimet për punë, postimin e profileve të theksuara të kompanive, postimet e kryqëzuara, etj. Nga ana tjetër, ata u ofrojnë punëkërkuarve mundësinë për të krijuar ose ngarkuar CV në portale. Disa portale ofrojnë më shumë shërbime se të tjerat dhe ato gjithashtu kanë një gamë mjaft të gjerë dhe të ndryshme të vizitave në uebfaqe, anëtarëve të regjistruar e kështu me radhë. Asnjë prej portaleve të anketuara nuk deklarojnë se mbajnë kontakt me punëkërkuarit dhe punëdhënësit për të kuptuar nëse dikush është punësuar duke përdorur portalet e punës ose kanalet e tjera të informacionit. Meqë nuk ka asnjë sistem të tillë, për të kuptuar suksesin e portaleve të punës në ndërmjetësimin e tregut të punës, portalet e punës duhet të krijojnë sisteme të përcjelljes së punëkërkuarve dhe punëdhënësve për të kuptuar nëse ata kanë ndihmuar në krijimin e vendeve të reja të punës. Kjo mund të bëhet duke krijuar anketa që shfaqen (‘pop up’) në portalet e tyre ose duke dërguar anketa me email tek kompanitë e regjistruara dhe anëtarët e regjistruar.

Në anën tjetër, një pjesë e madhe e të diplomuarve të shkollave profesionale konsiderojnë programet nga të cilat ata u diplomuan si të dobishme për shkak se ato përkojnë me kërkesat e tregut të punës, se kanë pasur mësues profesionistë, literaturë dhe mjete moderne, dhe se janë në gjendje të gjejnë punë me ato që kanë mësuar. Më pak se gjysma e të gjithë të diplomuarve të viteve akademike 2018/2019 dhe 2019/2020 janë të punësuar, por ata që janë të punësuar janë mbështetur kryesisht në familjet dhe miqtë e tyre për informata rreth punës dhe një pjesë të vogël është mbështetur në mediat sociale. Të gjithë të diplomuarit e shkollave profesionale, në fakt, mbështeten kryesisht në këtë kanal të informimit për mundësi të vendeve të punës edhe kur aplikojnë për punë të ndryshme. Vetëm një numër shumë i vogël i të anketuarve përmendën portalet e punës si një kanal të informimit për vendet e mundshme të punës. Ngjashëm, një numër shumë i vogël i të diplomuarve janë regjistruar në Agjencinë për Punësim të Republikës së Kosovës dhe disa nuk e dinë as që ekziston. Megjithatë, rreth gjysma e të gjithë të anketuarve gjithashtu besojnë se kanë një të ardhme të suksesshme profesionale dhe financiare. Edhe pse pjesë të konsiderueshme të të diplomuarve të arsimit profesional janë të kënaqur në përgjithësi dhe konsiderojnë programet e tyre janë të dobishme dhe pothuajse gjysma e tyre janë të punësuar tashmë, fushata informuese mbi përdorimin e burimeve të tilla si portalet e punës dhe platformat e mediave sociale mund të çojë në më shumë mundësi dhe ndoshta mundësi më të mira për punësim brenda dhe jashtë Kosovës.

Për më tepër, APRK gjithashtu duhet të rrisë ndërgjegjësimin publik për ekzistencën e vet dhe qëllimin e saj, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të krijojë bashkëpunime me ofruesit e trajnimeve, portalet e punës dhe qendrat e karrierës të shkollave për të ndërmjetësuar tregun e punës përmes të tri kanaleve.

## Aneks I: Lista e shkollave të kontaktuara për anketimin e të diplomuarve të AP-së

| <b>EYE Partner</b>    |  |
|-----------------------|--|
| <b>1</b>              | SHMM "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë                |
| <b>2</b>              | SHMLT "11 Marsi" - Prizren                         |
| <b>3</b>              | SHMLT "Nexhmedin Nixha" - Gjakovë                  |
| <b>4</b>              | SHMLT "Shaban Spahija" - Pejë                      |
| <b>5</b>              | SHMP "Jonuz Zejnullahu" - Viti                     |
| <b>6</b>              | SHMP "Bahri Haxha" - Vushtrri                      |
| <b>7</b>              | SHML "Zenel Hajdini" - Ferizaj                     |
| <b>8</b>              | Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" - Malishevë |
| <b>9</b>              | SHMT "Feriz Guri dhe Vëllezërit Caka" - Kaçanik    |
| <b>Jo Partner EYE</b> |  |
| <b>10</b>             | SHME "Kadri Kusari" - Gjakovë                      |
| <b>11</b>             | SHME "Ali Hadri" - Pejë                            |
| <b>12</b>             | SHMP "Fehmi Lladrovci" - Skënderaj                 |
| <b>13</b>             | SHMT "Skënder Luarasi" - Therandë                  |
| <b>14</b>             | SHMLP "Ismail Dumoshi" - Obiliq                    |
| <b>15</b>             | SHME "Marin Barleti" - Gjilan                      |
| <b>16</b>             | SHMAT "Abdyl Frashëri" - Prishtinë                 |

## Aneks II: Të diplomuarit e arsimit profesional (AP) sipas Komunës

|                   | Të diplomuarit e arsimit profesional | %    |
|-------------------|--------------------------------------|------|
| Ferizaj           | 8                                    | 2%   |
| Hani i Elezit     | 3                                    | 1%   |
| Kaçanik           | 39                                   | 8%   |
| Shtërpce          | 0                                    | 0%   |
| Shtime            | 0                                    | 0%   |
| Deçan             | 1                                    | 0%   |
| Gjakovë           | 67                                   | 13%  |
| Rahovec           | 2                                    | 0%   |
| Gjilan            | 32                                   | 6%   |
| Kamenicë          | 0                                    | 0%   |
| Kllokot           | 0                                    | 0%   |
| Partesh           | 0                                    | 0%   |
| Ranillug          | 0                                    | 0%   |
| Viti              | 35                                   | 7%   |
| Leposaviq         | 0                                    | 0%   |
| Mitrovicë         | 0                                    | 0%   |
| Mitrovicë Veriore | 0                                    | 0%   |
| Skenderaj         | 32                                   | 6%   |
| Vushtrri          | 3                                    | 1%   |
| Zubin Potok       | 0                                    | 0%   |
| Zveçan            | 0                                    | 0%   |
| Istog             | 7                                    | 1%   |
| Klinë             | 0                                    | 0%   |
| Pejë              | 63                                   | 13%  |
| Fushë Kosovë      | 1                                    | 0%   |
| Drenas            | 0                                    | 0%   |
| Graçanicë         | 0                                    | 0%   |
| Lipjan            | 1                                    | 0%   |
| Novobërdë         | 0                                    | 0%   |
| Obiliq            | 29                                   | 6%   |
| Podujevë          | 3                                    | 1%   |
| Prishtinë         | 68                                   | 14%  |
| Dragash           | 0                                    | 0%   |
| Malishevë         | 39                                   | 8%   |
| Mamushë           | 0                                    | 0%   |
| Prizren           | 41                                   | 8%   |
| Suharekë          | 26                                   | 5%   |
| Total             | 500                                  | 100% |